



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 224

Tiranë – E mërkurë, 3 dhjetor 2025

## PËRMBAJTJA

|                                                                                      | Page                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 710, datë 26.11.2025                         | Për miratimin e Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar, në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030 dhe të planit të veprimit..... 28023                                                                                                                                              |
| Urdhër i ministrit të<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 179, datë 19.11.2025   | Për delegim kompetence..... 28065                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural<br>nr. 1245, datë 21.11.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës..... 28066                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural<br>nr. 1246, datë 21.11.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës..... 28067                                                                                                                                                                                                                                                |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural<br>nr. 1247, datë 21.11.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 28068                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese<br>nr. 72, datë 17.11.2025                             | Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.<br>Prishjen/shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit..... 28069 |
| Vendim i Këshillit të Lartë<br>Gjyqësor nr. 795, datë 18.11.2025                     | Për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit..... 28072                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

|                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |       |
|------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 285, datë 13.11.2025 | Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....                                                                                                                                                                   | 28077 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 286, datë 13.11.2025 | Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                         | 28078 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 287, datë 13.11.2025 | Mbi licencimin e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                              | 28079 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 288, datë 13.11.2025 | Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyra 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Klisyrë’, me kapacitet prodhues 2 mw” .....                                                                                       | 28082 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 289, datë 13.11.2025 | Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                                            | 28084 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 292, datë 13.11.2025 | Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”.....                                                                                                                                                                                                         | 28086 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 293, datë 13.11.2025 | Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2025, “Mbi miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestionëve”.....                                                                                                                                                                           | 28087 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 295, datë 17.11.2025 | Mbi shqyrtimin e kërkesave të shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe Sindikatës Shqiptare të Taksive për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit, me fuqi të instaluar mbi 11 kw”..... | 28088 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 296, datë 17.11.2025 | Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘M.C Energji Gojan’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Gojan’”.....                                                                                                                                     | 28090 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 297, datë 17.11.2025 | Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw” .....                                                                                            | 28091 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 298, datë 17.11.2025 | Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Koka & Ergi Energy Stavec’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Stavec’, me kapacitet të instaluar 6250 kw” .....                                                                                         | 28092 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 299, datë 17.11.2025 | Mbi miratimin e “Strategjisë së ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative, 2025–2030” .....                                                                                                                                                                                                       | 28094 |

|                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |       |
|------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 300, datë 17.11.2025 | Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike..... | 28100 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 301, datë 17.11.2025 | Mbi licencimin e shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                                                          | 28102 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 302, datë 17.11.2025 | Mbi licencimin e shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                                                               | 28104 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 303, datë 17.11.2025 | Mbi dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Klos Torrent Works” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a.....                                                                                                                                                                            | 28106 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 304, datë 17.11.2025 | Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinet Consulting” sh.p.k.....                                                                                                                                                                                                                                        | 28108 |



**VENDIM****Nr. 710, datë 26.11.2025**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË  
PËR MODERNIZIMIN DHE  
HARMONIZIMIN E SISTEMEVE TË  
INFORMACIONIT DOGANOR  
SHQIPTAR, NË PËRPTHJE ME  
SISTEMET E INFORMACIONIT  
DOGANOR TË BASHKIMIT EVROPIAN,  
PËR PERIUDHËN 2025–2030 DHE TË  
PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar, në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030 dhe të planit të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**STRATEGJIA PËR MODERNIZIMIN DHE  
HARMONIZIMIN E SISTEMEVE TË  
INFORMACIONIT DOGANOR SHQIPTAR,  
NË PËRPTHJE ME SISTEMET E  
BASHKIMIT EVROPIAN PËR PERIUDHËN  
2025–2030 DHE PLANI I VEPRIMIT**

Përmbajtja

**KAPITULLI I: HYRJE**

- 1.1 Qëllimi i strategjisë
- 1.2 Konteksti i Integritetit Evropian
- 1.3 Sfidat e modernizimit
- 1.4 Përfitimet strategjike
- 1.5 Korniza strategjike dhe ligjore

1.6 Misioni dhe vizioni

**KAPITULLI II: ANALIZA E SITUATËS**

- 2.1 Gjendja aktuale e sistemit doganor shqiptar
- 2.2 Mangësitë kryesore të identifikuara
  - a) Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit
  - b) Korniza ligjore dhe rregullatore
  - c) Burimet njerëzore
  - d) Bashkëpunimi ndërinstitucional
- 2.3 Niveli i digjitalizimit të proceseve doganore
- 2.4 Lidhja me sistemet e BE-së
- 2.5 Sfidat e transformimit digjital
- 2.6 Justifikimi për reformën
- 2.7 Përfundimi i analizës

**KAPITULLI III: OBJEKTIVAT E STRATEGJISË**

- 3.1 Qëllimi i përgjithshëm
- 3.2 Objektivat specifike dhe shtyllat strategjike
  - 3.2.1 Shtylla 1: Zhvillimi i një sistemi doganor digjital, të integruar dhe koherent
  - 3.2.2 Shtylla 2: Modernizimi i administratës doganore dhe digjitalizimi i proceseve të brendshme
  - 3.2.3 Shtylla 3: Mbështetja e digjitalizimit të proceseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)
  - 3.2.4 Shtylla 4: Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK-ut në dogana
  - 3.2.5 Shtylla 5: Përmirësimi i aftësive teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar
- Përfitimet e synuara nga realizimi i objektivave të strategjisë

**KAPITULLI IV: SISTEMET QË DO TË ZBATOHEN**

- 4.1 Sistemi i Shkëmbimit të Certifikatave të Dritares së Vetme Doganore të BE-së (EU CSW - CERTEX)
- 4.2 Sistemi i Importit të Mallrave Kulturore (sistemi ICG)
- 4.3 Sistemi i Kontrollit të Importit të UCC 2 (ICS2)
- 4.4 Sistemi i Menaxhimit të Riskut Doganor (CRMS2)
- 4.5 Sistemi i Vendimeve Doganore të UCC (CDS)
- 4.6 Sistemi Uniform i Menaxhimit të Përdoruesit & Nënshkrimit Digjital (UUM&DS)
- 4.7 Sistemi i Eksportuesve të Regjistruar të UCC (REX)
- 4.8 Informacioni i Detyrueshëm Tarifor Evropian (EBTI)



4.9 Sistemi i Regjistrimit dhe Identifikimit të Operatorit Ekonomik të UCC 2 – EORI2

4.10 Mbikëqyrja e UCC 3 – SURV3

4.11 Fletët e Informacionit të UCC (INF) për Procedurat Speciale

4.12 Operatorët Ekonomikë të Autorizuar të UCC – AEO

4.13 Menaxhimi i Garancisë UCC (GUM)

4.14 Prova e Statusit të Unionit të UCC (PoUS)

4.15 COPIS (IPR *enforcement*)

4.16 Moduli TARIC (*Tarif Integre Communautaire*)

4.17 Moduli TQS (Kuotat Tarifore dhe Mbikëqyrja)

4.18 Moduli SMS (Sistemi i Menaxhimit të Specimeneve)

4.19 Moduli ECICS (Inventari Doganor Evropian i Substancave Kimike)

4.20 NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit)

4.21 Sistemi i Automatizuar i Eksportit (AES)

4.22 Zhdoganimi i Centralizuar i UCC për Import (CCI)

4.23 Njoftimi i Mbërritjes, Njoftimi i Prezantimit dhe Magazinimi i Përkohshëm AN/PN/TS sipas UCC

4.24 Sistemi Kombëtar i Importit të UCC (NIS)

4.25 *Integrated Tariff Management System* (ITMS)

KAPITULLI V: STRATEGJITË E ZBATIMIT DHE KPI-ve (KONTROLI I PERFORMANCËS SË INDIKATORËVE)

5.1 Masa konkrete të implementimit

5.2 Tabela e treguesve kryesorë të performancës (KPI)

5.3 Procedurat e Raportimit, Monitorimit dhe Vlerësimit të Progresit

KAPITULLI VI: FINANCIMI I STRATEGJISË

KAPITULLI VII: BASHKËPUNIMI RAJONAL

7.1 Rëndësia strategjike e bashkëpunimit rajonal

7.2 Kuadri politik dhe institucional i bashkëpunimit rajonal

7.3 Prioritetet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

a) Harmonizimi i procedurave dhe standardeve

b) Shkëmbimi elektronik i informacionit

c) Krijimi i korridoreve të gjelbra

7.4 Shembuj konkretë të bashkëpunimit rajonal

Shqipëri–Kosovë

Shqipëri–Maqedoni e Veriut

Shqipëri–Mali i Zi

Shqipëri–Greqi–Itali

7.5 Sfida të bashkëpunimit rajonal

7.6 Roli i BE-së dhe organizatave ndërkombëtare

7.7 Përfitimet e bashkëpunimit rajonal për Shqipërinë

7.8 Përfundim mbi bashkëpunimin rajonal

KAPITULLI VIII: PËRFUNDIME

8.1 Mbyllja e ciklit të reformës dhe rëndësia historike

8.2 Përfitimet institucionale dhe administrative

8.3 Përfitimet ekonomike dhe tregtare

8.4 Përfitimet sociale dhe politike

8.5 Ndikimi në procesin e integritetit evropian

8.6 Sfidat e ardhshme dhe qëndrueshmëria

8.7 Vizioni afatgjatë për Shqipërinë në sistemin doganor evropian

Shtojca 1: Plani i Veprimit të Strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor shqiptar në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030

Shtojca 2: Tabela e Kostimit të Strategjisë

## KAPITULLI I

### HYRJE

#### 1.1 Qëllimi i Strategjisë

Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor shqiptar, në përputhje me sistemet e Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030, ka si synim themelor zhvillimin e një administrate doganore moderne, të digjitalizuar dhe plotësisht të integruar me rrjetet doganore evropiane. Kjo strategji përfaqëson një instrument që do të garantojë efikasitet më të madh në procedurat doganore, rritje të transparencës dhe ulje të kostove administrative për bizneset, si dhe forcim të sigurisë kombëtare nëpërmjet menaxhimit më të mirë të kufijve dhe kontrollit të flukseve tregtare.

Qëllimi përfundimtar është që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një sistem doganor në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit Evropian (*Union Customs Code – UCC*), duke lehtësuar kështu integrimin gradual në tregun e përbashkët evropian dhe duke kontribuar në konsolidimin e procesit të anëtarësimit.

#### 1.2 Konteksti i Integritetit Evropian

Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga vitin 2014. Në vitin 2020



u hapën negociatat për anëtarësim dhe që nga viti 2022 ka nisur procesi i *screening*. Një ndër fushat ku është evidentuar domosdoshmëria për përparim të shpejtë është dogana, e cila lidhet drejtpërdrejt me lëvizjen e lirë të mallrave, si një nga katër liritë themelore të BE-së.

Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar më 8 maj 2025, qëndrimin e përbashkët të BE-së për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, për 8 kapituj të rinj të Grupimit të 3: “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”, duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm përpara në negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Ky grupim përfaqëson rritjen gjithëpërfshirëse për mirëqenie dhe përfshin tetë fusha, mes të cilave edhe kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”.

Në dokumentin e publikuar nga Komisioni Evropian pas përfundimit të Konferencës së Katërt Ndërqeveritare midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë në Bruksel, për kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”, nënvizohet se, BE-ja mirëpret kapacitetin adekuat administrativ dhe operacional të Shqipërisë për të përmbushur detyrat ekzistuese doganore. BE-ja fton Shqipërinë të forcojë më tej ndërtimin e kapaciteteve dhe rekrutimin e stafit përpara anëtarësimit, në veçanti në fushën e Teknologjisë së Informacionit (IT). BE-ja nënvizon nevojën që Shqipëria të vazhdojë të zhvillojë dhe përmirësojë sistemet ekzistuese IT, në përputhje me Planin Shumëvjeçar Strategjik për Doganat Digjitale, për të siguruar përafrimin me sistemet doganore të BE-së dhe për të garantuar ndërveprueshmërinë. BE-ja kujton nevojën që Shqipëria të alokojë burime të mjaftueshme financiare për të gjitha projektet IT në vijim dhe ato të planifikuara.

Në këtë kuadër, përafrimi i infrastrukturës ligjore dhe teknologjike të doganave shqiptare me atë të BE-së nuk është vetëm një kërkesë teknike, por një parakusht politik dhe ekonomik për avancimin e negociatave të anëtarësimit. Bashkimi Evropian e konsideron administratën doganore një element kyç të sigurisë së kufijve të jashtëm dhe të funksionimit të tregut të përbashkët.

### 1.3 Sfidat e modernizimit

Proceset aktuale të doganave shqiptare, janë të mbështetura dhe realizohen kryesisht në sistemin “ASYCUDA World”, e cila ka mundësuar një shkallë të caktuar digjitalizimi, por ende nuk

garantojnë integrim të plotë me platformat evropiane. Kjo situatë sjell disa sfida madhore:

- procedura të gjata dhe burokratike;
- mungesë ndërveprimi në kohë reale me autoritetet doganore të BE-së;
- nivel të ulët sigurie kibernetike;
- kosto të larta për bizneset dhe vonesa në qarkullimin e mallrave.

Këto sfida përbëjnë një pengesë serioze për konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare dhe për procesin e integritimit në BE.

### 1.4 Përfitimet strategjike

Zbatimi i kësaj strategjie do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta dhe afatgjata:

- Lehtësim tregtar: reduktim i kohës së zhdoganimit dhe rritje e efikasitetit në procedurat doganore;
- Integrim ekonomik: harmonizim me standardet e BE-së, duke i mundësuar Shqipërisë qasje në tregun e përbashkët;
- Transparencë dhe integritet: ulje të kontakteve fizike mes biznesit dhe administratës, me qëllim shmangien e korrupsionit;
- Siguri kombëtare: sisteme të avancuara të menaxhimit të riskut që parandalojnë kontrabandën dhe krimin ndërkufitar;
- Përfitime për bizneset: ulje e kostove administrative, thjeshtim i procedurave dhe përmirësim i mjedisit të investimeve, duke i bërë bizneset shqiptare plotësisht konkurruese në tregun ndërkombëtar.

### 1.5 Korniza strategjike dhe ligjore

Strategjia është në përputhje të plotë me:

- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2030;
- Strategjinë e Zhvillimit të Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030;
- Strategjinë e Reformës në Administratën Publike;
- Strategjinë e Biznesit 2023–2027 dhe plani i saj i zbatimit 2024 kanë përcaktuar prioritetet kryesore të reformës, duke përfshirë digjitalizimin, inovacionin teknologjik dhe rritjen e kapaciteteve institucionale;
- Angazhimet e marra nga Shqipëria në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- Strategjinë për evolucionin e bashkimit doganor (COM (2008) 169 final);
- Planin strategjik shumëvjeçar të BE-së për doganat elektronike (MASP-C);



- Listën e Sistemeve të dërguara nga DG Taxud dhe të përcjella zyrtarisht nga Zyra e Kryenegociatorit, nëpërmjet dokumentit “*Roadmap on development of digital customs systems required for the implementation of the EU customs legislation (updated 20 Jun 2025)*”.

Kjo strategji është, gjithashtu, e lidhur me procesin *screening* për kapitullin 29 “Bashkimi doganor”, që konsiderohen ndër kapitujt më të rëndësishëm të negociatave.

### 1.6 Misioni dhe vizioni

Misioni i Strategjisë është të transformojë Shërbimin Doganor të Republikës së Shqipërisë në një administratë moderne, digjitale, transparente dhe plotësisht të integruar me BE-në.

Vizioni i tij është që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një sistem doganor që funksionon sipas të njëjtave standarde, procedurave dhe teknologji si vendet anëtare të BE-së, duke ofruar shërbime të shpejta, të sigurta dhe efikase për qytetarët dhe bizneset.

## KAPITULLI II ANALIZA E SITUATËS

### 2.1 Gjendja aktuale e Sistemit Doganor Shqiptar

Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë është një institucion kyç i administratës publike financiare, duke mbikëqyrur lëvizjen e mallrave, si dhe duke garantuar të ardhurat buxhetore nga taksat doganore, si dhe duke siguruar mbrojtjen e interesave ekonomikë e kombëtarë. Prej disa vitesh, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt modernizimit të këtij sistemi, duke kaluar nga procedurat manuale tradicionale tek përdorimi i teknologjisë së informacionit.

Administrata Doganore e Shqipërisë aktualisht ka në përdorim sistemin *ASYCUDA World* (Sistemi i automatizuar për të dhënat doganore). Ky sistem gjithëpërfshirës i kompjuterizuar i menaxhimit doganor përfshin shumicën e procedurave të tregtisë së jashtme të trajtuara nga Administrata Doganore Shqiptare.

*ASYCUDA World* lehtëson përpunimin e listës së mallrave, deklaratave doganore, procedurave të kontabilitetit dhe listës së mallrave të magazinimit, duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e operacioneve doganore. Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore (*ASYCUDA World*) është një

sistem i kompjuterizuar i menaxhimit doganor që mbulon shumicën e procedurave të tregtisë së jashtme të administratës doganore shqiptare. Sistemi trajton deklaratat e listës së mallrave dhe doganore, procedurat e kontabilitetit dhe procedurat e listës së mallrave të magazinimit dhe pezullimit. Zbatimi i parë i *ASYCUDA ++* ishte në 2002 i cili në 2009 migroi në *ASYCUDA World* (AW). Në vitet 2018 – 2019, u zbatua menaxhimi uniform i përdoruesit dhe nënshkrimi elektronik, duke vijuar pa letra. Në janar 2022 u finalizua procesi i përmirësimit të versionit më të fundit të sistemit AW dhe në vitin 2022 u zbatuan shërbimet e internetit për shërbimet doganore në sistemin *e-Albania*. AW ndërvepron me sistemin *C@TS*, *Self-Care*, Bankat, Postën Shqiptare, SEED, *ASYCUDA World of Kosovo*, etj. Ky sistem ka sjellë përmirësime në menaxhimin e deklaratave doganore dhe në gjurmueshmërinë e proceseve, por mbetet i fragmentuar dhe i kufizuar për sa i përket integritetit të tij me platformat doganore të Bashkimit Evropian.

### 2.2 Mangësitë kryesore të identifikuara

Analiza e situatës aktuale tregon se sistemi doganor shqiptar përballet me sfida strukturore dhe teknologjike për t’u adresuar, të cilat ndahen në disa fusha kryesore:

#### a) Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit

- Pajisje dhe serverë të vjetruar, me kapacitet të kufizuar për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Mungesë të kapaciteteve e sistemeve rezervë;
- Rrezikshmëri e lartë ndaj sulmeve kibernetike për shkak të nivelit të ulët të sigurisë digjitale.

#### b) Korniza ligjore dhe rregullatore

- Përafrim i Kodit Doganor të Shqipërisë me Kodin Doganor të BE-së (*Union Customs Code* (UCC));

- Mungesë e akteve nënligjore dhe rregulloreve që garantojnë implementim të plotë të procedurave elektronike;

- Standardet për shkëmbimin e të dhënave dhe arkivimin elektronik nuk janë në përputhje të plotë me praktikën evropiane.

#### c) Burimet njerëzore

- Numër i kufizuar specialistësh të kualifikuar në fushën e IT-së dhe sistemeve doganore;
- Mungesë programesh të vazhdueshme trajnimi për sigurinë kibernetike, menaxhimin e riskut dhe ndërveprimin me sistemet e BE-së.



**d) Bashkëpunimi ndërinstitucional**

- Koordinimi jo plotësisht efektiv ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe institucioneve të tjera publike ligjzbatuese;

- Proceset shpesh mbivendosen dhe krijojnë vonesa, duke ulur efikasitetin e përgjithshëm të administratës.

**2.3 Niveli i digjitalizimit të proceseve doganore**

Sipas vlerësimeve të brendshme të Shërbimit Doganor, shumica e procedurave thelbësore janë ende pjesërisht të digjitalizuara. Prej datës 16.5.2019, deklarimi i mallrave në doganë realizohet *online* (pa letra), duke aplikuar nënshkrimin dhe vulosjen elektronike. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm që shoqëron deklaratën doganore është në formë elektronike dhe i bashkëngjitet deklaratës doganore. Me vendosjen e vulës elektronike të gjitha deklaratat doganore paraqiten në formë elektronike përveç deklaratave doganore që klasifikohen ose rikanalizohen në kanal të kuq (kontroll dokumentar dhe fizik të mallrave) paraqiten dhe në letra. Që prej marsit 2022, ADSH-ja ofron shërbime për bizneset nëpërmjet aplikacionit *e-Albania*, një portal qeveritar që integron sisteme të ndryshme institucionale.

Deri më sot janë digjitalizuar 38 shërbime doganore, ku përfshihen “Deklarata e thjeshtuar”, “Deklarata e statusit të tranzitit” dhe “Konfirmimi i pagesave të kryera nga subjektet në llogaritë doganore”. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofron aktualisht 43 shërbime *online*, dhe synon kalimin e të gjitha shërbimeve *online* deri në fund të vitit 2026.

**Digjitalizimi i Shërbimeve Doganore:** Është sistemi *backend*, ky sistem përpunon aplikacionet e paraqitura përmes platformës *e-albania*. Ai funksionon sipas flukseve të punës dhe afateve kohore të paracaktuara për çdo shërbim, duke siguruar që qytetarët të marrin përgjigje të menjëhershme të shoqëruara me dokumente të nënshkruara elektronikisht.

**LIMS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik):** Është sistemi i cili realizon regjistrimin dhe menaxhimin për analizat e mostrave të mallrave dhe është implementuar për herë të parë në vitin 2017. Sistemi është përmirësuar në vitin 2023 sipas strukturës së re të institucionit dhe fluksit të ri të punës përpunuese. Ky përmirësim e përaftron sistemin me strukturën e re të institucionit dhe fluksin e punës së përpunimit, duke

përmirësuar kështu saktësinë dhe shpejtësinë e analizës së mallrave.

**ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave):** I nisur si projekt nga Bashkimi Evropian në vitin 2019, ITMS-ja përfshin tetë module thelbësore të zhvilluara nga SIVECO. Sistemi u instalua në infrastrukturën *harduer* të AKSHI-t dhe iu dorëzua administratës doganore në shkurt 2024. Pas dorëzimit, administrata doganore kreu teste të plota bazuar në skenarë të propozuar nga SIVECO/IkubInfo, duke siguruar gatishmërinë operacionale të sistemit.

Aktualisht, janë disa sisteme të cilat janë në proces dhe nuk janë implementuar ende, si më poshtë:

- **NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit):** Ky projekt i mbështetur nga Banka Botërore ka nisur në mars 2020. Lidhur me paketën e prokurimit “Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Kontrolli i Cilësisë për Zbatimin e plotë të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit (NCTS) në Shqipëri” me nr. WBTF-ALB-121D, datë 3.6.2022, u zgjodh konsulenti fitues dhe u kontraktua nga Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU).

Në lidhje me procedurën e prokurimit “*Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit plotësisht në përputhje me EU-NCTS*”, ref. nr. WBTF-ALB-121B”, kompania fituese (NETCompany-Intrasoft) u zgjodh dhe u kontraktua nga CFCU-ja, në qershor 2024. ADSH-ja po punon me ekspertin ndërkombëtar për Strategjinë Kombëtare të TI-së, Udhërrëfyesin dhe Planin e Veprimit (NISRAP) për NCTS të cilën do t’ia përcjellë zyrtarisht TAXUD-it. Gjithashtu, ADSH-ja ka krijuar grupin e punës për zbatimin e “Sistemit të ri të Kompjuterizuar të Tranzitit NCTS”. Ky grup përbëhet nga ekspertë të ndryshëm të procedurave doganore, ligjeve, garancive, pagesave, IT, riskut, etj.

- **NSW (dritare e re e vetme):** Është një projekt i Bankës Botërore i cili ka filluar në tetor 2020. CFCU-ja kontrakttoi kompaninë konsulente IOS Partners, që synon të përgatisë specifikimet teknike të nevojshme për fillimin e punës për zbatimin e Sistemit të Dritares së Vetme Kombëtare (NSW). Kompania *IOS Partners* ka përgatitur Raportin Fillestar dhe dokumentin TOR. TOR-ët janë miratuar nga BB-ja dhe tani nuk do të marrin asnjë kundërshtim nga dokumenti RFP i Bankës, që do të publikohet për tender nga CFCU-ja gjatë muajit



shtator. Procedura e prokurimit është në proces vlerësimi, në të cilin është krijuar një komision specifik për vlerësimin e tij.

#### 2.4 Lidhja me sistemet e BE-së

Shqipëria është ende në fazat përgatitore për t'u lidhur me disa nga sistemet kryesore të BE-së.

| Sistemi i BE-së | Gjendja në Shqipëri       | Niveli i ndërveprimit | Shënime                                               |
|-----------------|---------------------------|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| NCTS (tranzit)  | Në fazë përgatitore pilot | Pjesërisht            | Pritet aderimi në Konventën e Tranzitit të Përbashkët |
| AES (eksport)   | I pazbatuar               | Mungon                | Parashikuar për vitet 2026–2027                       |
| AIS (import)    | I pazbatuar               | Mungon                | Parashikuar për vitet 2027–2028                       |
| EORI            | I pazbatuar               | Mungon                |                                                       |
| TARIC           | I pazbatuar               | Mungon                | Planifikohet për 2027                                 |

#### 2.5 Sfidat e transformimit digjital

Procesi i transformimit digjital të doganave shqiptare do të duhet të adresojë:

- mungesën e ndërlidhjes me rrjetet evropiane;
- procedurat manuale dhe të ngadalta;
- infrastrukturën e vjetruar të IT-së;
- kapacitetin e ulët institucional për menaxhimin e projekteve digjitale.

Këto kufizime gjenerojnë kosto të larta administrative, një përvojë jo të favorshme për bizneset, si dhe një rrezik të lartë për mashtrime dhe korrupsion. Në të njëjtën kohë, ato e pengojnë Shqipërinë të bëhet pjesë e plotë e zinxhirit të integruar doganor evropian.

#### 2.6 Justifikimi për reformën

Reforma e sistemit doganor digjital është një domosdoshmëri për:

- përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë ndaj BE-së;
- sigurimin e zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe të një mjedisi biznesi konkurrues;
- përmirësimin e menaxhimit të të ardhurave publike dhe uljen e evazionit fiskal;
- forcimin e luftës kundër kontrabandës dhe krimit ndërkufitar.

Moszbatimi i reformës rrezikon:

- ngadalësimin e negociatave të anëtarësimit në BE;
- kufizimin e aksesit në fondet evropiane;

- humbjen e mundësive për integrim në tregtinë ndërkombëtare të digjitalizuar.

#### 2.7 Përfundimi i analizës

Nga analiza e mësipërme rezulton se administrata doganore shqiptare gjendet përballë një sfide dhe transformimi të plotë teknologjik dhe institucional për t'u përafëruar me standardet evropiane. Ky transformim kërkon jo vetëm investime në infrastrukturë dhe teknologji, por edhe forcim të kuadrit ligjor, ndërtim të kapaciteteve njerëzore dhe rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional e rajonal.

### KAPITULLI III

### OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

#### 3.1 Qëllimi i përgjithshëm

Me qëllim që sistemi doganor i Republikës së Shqipërisë të përafërohet me standardet e Bashkimit Evropian dhe t'i përshtatet nevojave gjithnjë e më të mëdha për digjitalizim, efikasitet dhe siguri të proceseve doganore, Strategjia përcakton një sërë objektivash themelore. Këto objektivat rrjedhin nga angazhimet e marra nëpërmjet Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2025–2030, nga Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030, si dhe nga kërkesat e përcaktuara në Strategjinë për Evolucionin e Bashkimit Doganor (COM (2008) 169 final).

Qëllimi kryesor i zhvillimit të Strategjisë për modernizimin dhe harmonizimin e sistemeve të informacionit doganor të Shqipërisë me ato të Bashkimit Evropian është modernizimi dhe harmonizimi i këtyre sistemeve deri në vitin 2030, duke siguruar ndërveprimin, sigurinë dhe efikasitetin e proceseve doganore. Ky objektiv i përgjithshëm synon transformimin e administratës doganore shqiptare në një strukturë moderne dhe plotësisht të integruar me sistemet doganore të BE-së, duke mundësuar shkëmbim efikas të të dhënave, rritjen e transparencës, lehtësimin e tregtisë së ligjshme dhe garantimin e mbledhjes efektive të të ardhurave.

#### 3.2 Objektivat specifike dhe shtyllat strategjike

Objektivat e Strategjisë ndërtohen mbi pesë shtylla strategjike që mbulojnë të gjitha dimensionet thelbësore të modernizimit të administratës doganore shqiptare: infrastrukturën e teknologjisë së informacionit (TIK), proceset operative doganore, shërbimet dhe mbështetjen për biznesin, kuadrin

rregullator dhe strategjitë e TIK-ut, si dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Këto shtylla synojnë zbatimin e plotë të një sistemi doganor plotësisht digjital, të sigurt dhe të ndërveprueshëm, i cili lehtëson tregtinë e ligjshme, siguron mbledhjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe mbështet integrimin e Republikës së Shqipërisë në zonën doganore evropiane.

### **3.2.1 Shtylla 1: Zhvillimi i një sistemi doganor digjital, të integruar dhe koherent**

Ky objektiv strategjik synon të realizojë një reformë strukturore dhe funksionale të administratës doganore, duke integruar teknologjitë moderne digjitale në të gjitha proceset kyçe doganore. Në kuadër të kësaj shtylle, do të zhvillohet një sistem i plotë elektronik doganor (CDPS – *Sistemi i Përpunimit të Vendimeve Doganore*), i cili do të jetë plotësisht i ndërveprueshëm me rrjetet dhe platformat e TIK-ut të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtij sistemi, Shërbimi Doganor synon të rrisë transparencën, të përmirësojë efikasitetin operativ, të forcojë sigurinë kibernetike dhe të sigurojë përputhshmëri të plotë me legjislacionin doganor evropian.

Zbatimi i këtij objektiwi do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të unifikuar digjital doganor, i cili mundëson lidhjen në kohë reale me sistemet doganore evropiane (si p.sh.: NCTS, AES, AIS, EORI, REX, AEO), automatizon shkëmbimin e të dhënave midis autoriteteve dhe operatorëve ekonomikë dhe lejon menaxhimin e integruar elektronik të proceseve të deklarimit dhe kontrollit të autoritetit doganor. Përveç kësaj, sistemi i ri do të përfshijë elemente bashkëkohore të identifikimit dhe autentikimit elektronik, si dhe nënshkrimin digjital, duke forcuar besimin dhe sigurinë në marrëdhëniet digjitale mes administratës shtetërore dhe komunitetit të biznesit.

Duke arritur këtë objektiv, administrata doganore do të shkurtojë ndjeshëm kohën e përpunimit të deklarave doganore, do të minimizojë risqet e gabimeve njerëzore dhe do të krijojë një klimë lehtësuese për integrimin ekonomik me BE-në, duke lehtësuar tregtinë ndërkufitare, si dhe duke nxitur konkurrueshmërinë ekonomike të vendit.

Për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.1.1 Zhvillimi i një CDPS-je (*Sistemi i Përpunimit të Vendimeve Doganore*) të re shqiptare në përputhje me kërkesat e BE-së, që të mundësojë një

mjedis doganor plotësisht elektronik dhe të integruar në nivel evropian.

3.2.1.2 Modernizimi i sistemeve të kontrollit doganor dhe menaxhimit të riskut, duke integruar mjetet e avancuara të analizës së të dhënave, si dhe inteligjencës artificiale për të identifikuar dhe parandaluar riskun në kohë reale.

3.2.1.3 Optimizimi dhe digjitalizimi i procedurave të veçanta (regjimet doganore të posaçme si përpunimi aktiv/pasiv, magazinimi doganor, njoftimi i mbërritjes dhe pranimi i magazinimit të përkohshëm, etj.), në linjë me standardet evropiane INF-STP dhe INF-SP, për t'i bërë ato më efikase dhe transparente.

3.2.1.4 Zhvillimi dhe përsosja e sistemit të akcizës, duke e integruar atë me sistemet doganore dhe tatimore për një administrim më të mirë të taksave indirekte dhe përputhshmëri me *acquis* të BE-së në fushën e akcizave.

### **3.2.2 Shtylla 2: Modernizimi i administratës doganore dhe digjitalizimi i proceseve të brendshme**

Transformimi digjital i shërbimit doganor nuk mund të arrihet pa një reformë të thellë të proceseve të brendshme. Prandaj, objektivi i dytë fokusohet te digjitalizimi i proceseve të mbështetjes së brendshme, si: menaxhimi i burimeve njerëzore, prokurimi, buxheti, logjistika përmes implementimit të një sistemi bashkëkohor ERP (planifikim të burimeve të brendshme) të përshtatur për nevojat e administratës doganore. Kjo do të mundësojë automatizimin dhe integrimin e funksioneve administrative, duke rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe koordinimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm të administratës.

Gjithashtu, të gjitha regjimet doganore (regjimet doganore të posaçme, si: përpunimi aktiv/pasiv, magazinimi doganor, njoftimi i mbërritjes, pranimi i magazinimit të përkohshëm dhe transiti, etj.) do të duhet të digjitalizohen plotësisht, në përputhje me standardet dhe formatet elektronike të kërkuara nga BE-ja (p.sh. përdorimi i sistemeve INF-STP/INF-SP për shkëmbimin e informacionit për procedurat e posaçme). Në të njëjtën kohë, sistemet për menaxhimin e riskut, parandalimin e mashtrimit dhe ndarjen automatike të kuotave tarifore do të forcohen duke zbatuar platforma dhe aplikacione të specializuara (si: AFIS, COPIS dhe TQS), të cilat rrisin kapacitetin e identifikimit të shkeljeve dhe garantimin e mbledhjes së saktë të detyrimeve



doganore. Paralelisht me këto, do të duhet të zhvillohet një sistem i integruar i menaxhimit të burimeve (fizike, teknologjike dhe njerëzore) për të optimizuar përdorimin e aseteve të administratës.

Këto veprime, marrë së bashku, do të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e efikasitetit operacional brenda administratës doganore dhe do të zvogëlojnë burokracinë e panevojshme. Proceset më të thjeshtuara dhe të automatizuara të brendshme do të reflektohen në shërbime më cilësore dhe më të shpejta për qytetarët dhe bizneset. Prandaj, për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.2.1 Optimizimi dhe digjitalizimi i plotë i procedurave doganore, duke krijuar module të posaçme elektronike për secilën procedurë (p.sh. tranziti elektronik, regjimet e përpunimit dhe magazinimit, etj.) në harmoni me sistemet evropiane.

3.2.2.2 Zbatimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të burimeve (fizike, TIK dhe njerëzore) për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës doganore, nëpërmjet investimeve strategjike, masave të avancuara për mbrojtjen e të dhënave, dhe mbështetjes digjitale të të gjitha proceseve operacionale. Ky sistem do të garantojë që infrastruktura kritike (si pajisjet *hardware*, rrjetet, bazat e të dhënave dhe vetë strukturat organizative) të jetë e aftë t'u përgjigjet kërkesave në rritje dhe sfidave emergjente.

### 3.2.3 Shtylla 3: Mbështetja e digjitalizimit të proceseve të biznesit (shërbimet për komunitetin ekonomik)

Në një kontekst ekonomik, ku konkurrueshmëria dhe shpejtësia janë kyçe, është thelbësore që marrëdhënia midis doganës dhe operatorëve ekonomikë të transformohet në mënyrë digjitale dhe të ofrojë shërbime të shpejta e transparente. Ky objektiv synon të zhvillojë zgjidhje moderne TIK që ofrojnë shërbime elektronike efikase dhe të gjithanshme për mjedisin e biznesit, duke krijuar platforma elektronike miqësore për përdoruesit, të disponueshme 24/7 dhe të integruara me sistemet përkatëse të BE-së.

Brenda kësaj shtylle, do të zhvillohet një sistem mbështetjeje teknike shumënivelësh (*help desk*), që t'u përgjigjet në mënyrë proaktive dhe të shpejtë kërkesave apo problemeve teknike të përdoruesve (si bizneseve edhe administratës doganore). Gjithashtu, do të integrohen funksionalitete digjitale

në procesin e komunikimit midis doganës dhe palëve të jashtme: aplikimet për autorizime doganore, llogaritja dhe pagesa elektronike e detyrimeve dhe menaxhimi elektronik i vendimeve doganore do të ofrohen tërësisht *online* dhe në kohë reale. Këto masa do të sigurojnë transparencë dhe parashikueshmëri më të madhe në zbatimin e regjimeve doganore, si dhe do të ulin ndjeshëm kostot e përputhshmërisë për operatorët ekonomikë (duke pakësuar dokumentacionin në letër, kohën e pritjes dhe ndërveprimet fizike).

Për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohen objektivat specifike të mëposhtëm:

3.2.3.1 Përmirësimi i shërbimeve elektronike doganore për komunitetin e biznesit, duke zgjeruar gamën dhe cilësinë e platformave digjitale (portalet e biznesit dhe aplikacionet mobile, etj.) ku operatorët ekonomikë mund të kryejnë të gjitha formalitetet doganore pa pengesa.

3.2.3.2 Shfrytëzimi strategjik i burimeve për mirëmbajtjen dhe modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknologjike dhe asaj fizike, në mënyrë që sistemet doganore të jenë vazhdimisht të disponueshme, të sigurta dhe të përditësuara me teknologjinë më të re.

3.2.3.3 Ngritjen e një kapaciteti rezervë për rikuperimin e shpejtë të sistemeve dhe të dhënave në rast fatkeqësish ose emergjencash. Kjo do të sigurojë që të dhënat konfidenciale doganore dhe biznesit të jenë të mbrojtura sipas standardeve më të larta dhe që operacionet doganore të mos ndërpriten edhe në rast të incidenteve madhore kibernetike apo fizike.

### 3.2.4 Shtylla 4: Përditësimi i kuadrit strategjik dhe rregullator të TIK-ut në dogana

Digjitalizimi i shërbimit doganor kërkon jo vetëm sisteme TIK me performancë të lartë, por edhe një kuadër rregullator, strategjik dhe organizativ të mirëpërcaktuar. Në këtë drejtëm, objektivi i katërt synon të forcojë bazat strategjike dhe ligjore mbi të cilat mbështetet transformimi digjital i doganave.

Së pari, do të hartohet dhe zhvillohet një arkitekturë e integruar për TIK-un në sistemin doganor shqiptar, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes për të gjitha projektet dhe investimet e ardhshme në fushën e teknologjisë. Kjo arkitekturë do të sigurojë që sistemet e reja të jenë të përputhura me standardet evropiane dhe të mundësojnë



ndërveprim të plotë me sistemet e BE-së dhe agjencitë e tjera brenda vendit.

Gjithashtu, rregulloret e brendshme, politikat e sigurisë, protokollet e aksesit në të dhëna dhe rregullat e qeverisjes së IT-së do të rishikohen dhe përditësohen, me qëllim krijimin e një kuadri modern ligjor që mbështet një mjedis plotësisht të digjitalizuar. Kjo përfshin përshtatjen e legjislacionit doganor shqiptar me Kodin Doganor të BE-së, sa i përket përdorimit të dokumenteve elektronike dhe nënshkrimit digjital, miratimin e procedurave “pa letër”, si dhe garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe tregtare, në përputhje me rregulloren GDPR (rregullore e përgjithshme e mbrojtjes së të dhënave) të BE-së.

Për të përmirësuar monitorimin e investimeve dhe projekteve TIK, do të krijohet një regjistër i centralizuar i projekteve dhe dokumentacionit përkatës. Kjo do t'i mundësojë administratës doganore të ndjekë në mënyrë të rregullt progresin e secilit projekt, të sigurojë përputhshmërinë me standardet dhe afatet, si dhe të vlerësojë efikasitetin e shpenzimeve publike në TIK.

Për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohet objektivi specifik i mëposhtëm:

- 4.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një kornize të plotë të arkitekturës për TIK-un në dogana, që përcakton standardet teknike, proceset e menaxhimit të ndryshimit dhe kontrollit të cilësisë, dhe udhëzon integrimin e çdo sistemi të ri me infrastrukturën ekzistuese dhe sistemet e BE-së. Ky objektiv i veçantë siguron që transformimi digjital të mbështetet nga një strategji e qëndrueshme dhe një strukturë qeverisjeje që garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave.

### 3.2.5 Shtylla 5: Përmirësimi i aftësive teknologjike dhe mbajtja e stafit të kualifikuar

Suksesi i transformimit digjital varet drejtpërdrejt nga kapitali njerëzor. Për këtë arsye, objektivi i pestë i strategjisë fokusohet në forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të punonjësve, veçanërisht atyre në fushën e TIK-ut, si dhe në krijimin e kushteve që këta specialistë të qëndrojnë dhe të zhvillojnë karrierën e tyre brenda administratës doganore.

Do të duhen të organizohen kurse dhe trajnime të specializuara për stafin e TIK-ut dhe stafin tjetër doganor që punon me sistemet e reja digjitale. Këto trajnime do të duhet të mbulojnë fusha kyçe si ndërveprimi i sistemeve doganore me ato evropiane,

siguria kibernetike, administrimi i bazave të të dhënave, zhvillimi i *software*-it, menaxhimi i projekteve TIK dhe analiza e të dhënave. Trajnimet do të ofrohen në mënyrë të vazhdueshme për të ndjekur ritmin e avancimit teknologjik dhe për të siguruar që stafi të jetë gjithmonë i përditësuar me praktikatat më të mira.

Në të njëjtën kohë, do të duhen të krijohen paketa motivuese dhe politika konkurruese të shpërblimit për personelin teknik. Kjo do të përfshijë skema stimuljesh (bonuse performance për arritjen e objektivave kyç), mundësi karriere dhe avancimi profesional brenda institucionit, si dhe një ristrukturim të skemës së pagave për profilet TIK, në mënyrë që ato të jenë konkurruese me tregun privat dhe të afta të tërheqin e të mbajnë specialistë të talentuar.

Kështu, për të arritur këtë objektiv të përgjithshëm, formulohet objektivi specifik i mëposhtëm:

|                                                                                                                            | Kosto Indikative Qëllimi i Politikës (Shtylla) 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                           |                           |                     |                 | 93,500,005              | 194,087,499            | -                 | 287,587,504  |



## Kostimi i Planit të Veprimit

[illegible]

## URDHËR

**Nr. 179, datë 19.11.2025**

## PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

## URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Besjan Kadiu, për nënshkrimin e:

- a) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkim, zbulim dhe shfrytëzimit për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për t'u pajisur me leje minerare;
- b) njoftimit për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare;
- c) njoftimit për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;
- ç) vendimit për revokimin e lejeve minerare;
- d) aktit për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;
- dh) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkim, zbulim dhe shfrytëzimit për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;
- e) aktit të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;
- ë) aktit për miratimin e nënkontrakteve;
- f) shkresës së korrespondencës me QKB për sektorin mineral;
- g) miratimit dhe refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë privatë ose





publikë, vendës apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse.

gj) urdhrit për kthimin apo moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe investimit;

h) urdhrit për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Besjan Kadiu, i ndjek dhe i zbaton ato në mbështetje të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ligjit nr. 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë urdhër.

3. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 121, datë 1.9.2025, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Besjan Kadiu, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Belina Balluku**

**URDHËR**  
**Nr. 1245, datë 21.11.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3* |
|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Hauts-de-France                   | Pas-de-Calais                     | Calais*                            |
| <b>Pays de la Loire</b>           | <b>Maine-et-Loire</b>             | <b>Cholet*</b>                     |
| Pays de la Loire                  | Loire-Atlantique                  | Châteaubriant*                     |
| Pays de la Loire                  | Vendée                            | Fontenay-le-Comte*                 |
| Nouvelle-Aquitaine                | Lot-et-Garonne                    | Nérac*                             |
| Grand Est                         | Haute-Marne                       | Saint-Dizier*                      |
| Centre-Val de Loire               | Cher                              | Bourges*                           |
| Auvergne-Rhône-Alpes              | Allier                            | Moulins*                           |
| Auvergne-Rhône-Alpes              | Loire                             | Montbrison*                        |
| Bourgogne-Franche-Comté           | Côte-d'Or                         | Beaune*                            |
| <b>Bourgogne-Franche-Comté</b>    | <b>Côte-d'Or</b>                  | <b>Dijon*</b>                      |
| Grand Est                         | Marne                             | Vitry-le-François*                 |
| <b>Pays de la Loire</b>           | <b>Loire-Atlantique</b>           | <b>Nantes*</b>                     |
| Pays de la Loire                  | Vendée                            | Les Sables-d'Olonne*               |
| Pays de la Loire                  | Vendée                            | La Roche-sur-Yon*                  |
| <b>Nouvelle-Aquitaine</b>         | <b>Deux-Sèvres</b>                | <b>Bressuire*</b>                  |
| Nouvelle-Aquitaine                | Dordogne                          | Périgueux*                         |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të





patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1238, datë 20.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Andis Salla**

**URDHËR**  
**Nr. 1246, datë 21.11.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE  
ME PATOGJENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E BELGJIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3* |
|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| Vlaanderen                        | Limburg                           | Maaseik*                           |
| Vlaanderen                        | West-Vlaanderen                   | Diksmuide*                         |
| Vlaanderen                        | Antwerpen                         | Turnhout*                          |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.



7. Urdhri nr. 1105, datë 30.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Andis Salla**

**URDHËR**  
**Nr. 1247, datë 21.11.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË  
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kripasje nuk është bërë trajtimi me

temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70 °C në 3.6 sekonda;
- iii. 74 °C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3* |
|-----|-----------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1   | Malopolskie                       | Brzesko                           | Czchów*                            |
| 2   | Śląskie                           | Gliwice (City)                    | Gliwice*                           |
| 3   | Śląskie                           | Gliwice                           | Toszek*                            |
| 4   | Podlaskie                         | Siemiatycze                       | Nurzec-Stacja*                     |
| 5   | Podlaskie                         | Białystok                         | Łapy*                              |
| 6   | Malopolskie                       | Tarnów                            | Wojnicz*                           |
| 7   | Kujawsko-Pomorskie                | Toruń                             | Chelmża (rural)*                   |
| 8   | Malopolskie                       | Bochnia                           | Bochnia*                           |
| 9   | Podkarpackie                      | Przemyśl                          | Krasieczyn*                        |
| 10  | Warmińsko-Mazurskie               | Działdowo                         | Iłowo-Osada*                       |
| 11  | Podlaskie                         | Białystok                         | Supraśl*                           |
| 12  | Lubelskie                         | Łęczna                            | Ludwin*                            |
| 13  | Pomorskie                         | Nowy Dwór Gdański                 | Ostaszewo*                         |
| 14  | Świętokrzyskie                    | Jędrzejów                         | Sędziszów*                         |
| 15  | Mazowieckie                       | Wolomin                           | Tłuszcz*                           |
| 16  | Podkarpackie                      | Przemyśl                          | Stubno*                            |
| 17  | Malopolskie                       | Bochnia                           | Nowy Wiśnicz*                      |
| 18  | Świętokrzyskie                    | Staszów                           | Staszów*                           |
| 19  | Podkarpackie                      | Przemyśl                          | Medyka*                            |
| 20  | Pomorskie                         | Malbork                           | Miloradz*                          |
| 21  | Mazowieckie                       | Żuromin                           | Bieżun*                            |
| 22  | Mazowieckie                       | Żuromin                           | Żuromin*                           |
| 23  | Łódzkie                           | Piotrków                          | Wolbórz*                           |
| 24  | Łódzkie                           | Rawa                              | Rawa Mazowiecka (rural)*           |
| 25  | Pomorskie                         | Kartuzy                           | Sierakowice*                       |
| 26  | Mazowieckie                       | Gostynin                          | Gostynin (rural)*                  |
| 27  | Mazowieckie                       | Sierpc                            | Szczutowo*                         |
| 28  | Mazowieckie                       | Sierpc                            | Rościszewo*                        |
| 29  | Podkarpackie                      | Mielec                            | Radomyśl Wielki*                   |
| 30  | Świętokrzyskie                    | Kielce                            | Mniów*                             |
| 31  | Podlaskie                         | Mońki                             | Goniadz*                           |
| 32  | Wielkopolskie                     | Wolsztyn                          | Wolsztyn*                          |
| 33  | Wielkopolskie                     | Ostrów Wielkopolski               | Nowe Skalmierzyce*                 |
| 34  | Kujawsko-Pomorskie                | Aleksandrów                       | Zakrzewo*                          |
| 35  | Lubuskie                          | Wschowa                           | Wschowa*                           |
| 36  | Wielkopolskie                     | Poznań                            | Stęszew*                           |
| 37  | Wielkopolskie                     | Leszno                            | Wąjewo*                            |
| 38  | Zachodniopomorskie                | Białogard                         | Białogard (rural)*                 |
| 39  | Podlaskie                         | Mońki                             | Knyszyn*                           |
| 40  | Podlaskie                         | Sokółka                           | Janów*                             |
| 41  | Opolskie                          | Opole                             | Niemodlin*                         |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 2.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 1211, datë 17.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Andis Salla**

## VENDIM

Nr. 72, datë 17.11.2025

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
e përbërë nga:

|                      |            |
|----------------------|------------|
| Marsida Xhaferllari, | kryesuese; |
| Fiona Papajorgji,    | anëtare;   |
| Sonila Bejtja,       | anëtare;   |
| Ilir Toska,          | anëtar;    |
| Genti Ibrahimimi,    | anëtar;    |
| Marjana Semini,      | anëtare;   |
| Sandër Beci,         | anëtar,    |

me sekretare Anjeza Puka, në datën 17.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (V) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “Vega” sh.a., e përfaqësuar nga administratorja Artenida Dervishi dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës, avokat Erjon Kanxheri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Zyra e Përmbartimit privat “Jus” sh.p.k.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Prishja/shfuqizimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 44, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim kërkesën e kërkuases, shoqërisë “Vega” sh.a. (*kërkuesja*), për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe konstatoi mungesën e mendimeve me



shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë (MIE) dhe Zyrës së Përmbartimit Privat “Jus” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja në datën 10.6.2011 ka lidhur me Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës (MTI) “Marrëveshje për caktimin dhe rinovimin e kontratës për ndërtimin e ndërtesës së terminalit të trageteve Durrës dhe infrastrukturës së kantierit lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe SCT d.d. më 6 maj 2008”. Sipas pikës 20.6. të këtij akti, përveçse kur zgjidhet në mënyrë miqësore, çdo mosmarrëveshje zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar, sipas rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC).

2. Për shkak se mes palëve kanë lindur mosmarrëveshje për zbatimin e kontratës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC-së. Kjo e fundit, me vendimin nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, ka vendosur pjesërisht në favor të kërkueses.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 97, datë 3.5.2017, ka vendosur njohjen dhe dhënien fuqi ligjore vendimit të ICC-së nr. 21069/MHM, datë 29.11.2016, duke lëshuar edhe urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim. Për rrjedhojë, kërkuesja i është drejtuar shërbimit përmbartimor gjyqësor privat për ekzekutimin e tij. Në datën 18.12.2017 MTI-ja ka ekzekutuar pagesën e detyrimeve dhe kostove procedurale, por pa përfshirë interesat për vonesën. Emërtimi i MTI-së ka ndryshuar në MIE. Për këtë qëllim, në këtë vendim emrat e institucioneve janë përdorur në përkëmbim të njëri-tjetrit.

4. Në datën 11.12.2018 MIE-ja ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt pezullimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, si dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbartuesit privat. Me vendimin nr. 10718, datë 26.12.2018, ajo gjykatë ka vendosur shpalljen e moskompetencës për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vijim, ajo gjykatë, me vendimin nr. 1228, datë

29.6.2020, ka vendosur pranimin e padisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesja dhe Zyra e Përmbartimit Privat “Jus” sh.p.k.

5. Me vendimin nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Mbi rekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Në datën 3.6.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 10.6.2025. Në datën 30.7.2025 një gjyqtar, pas njohjes me aktet, ka paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me anë të vendimit nr. 19, datë 30.7.2025, ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë. Kolegji i Gjykatës (pas plotësimit me anëtarin zëvendësues), në datën 31.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 29.10.2025 kërkuesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual i paraqitur në datën 3.6.2025.

### II Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kufijtë ligjorë rishqyrtues. Ajo gjykatë ka shqyrtuar e vlerësuar prova dhe fakte, të cilat janë vlerësuar dhe arsyetuar nga gjykatat më të ulëta dhe asnjë palë nuk ka pasur pretendime. Rekursi i referohet interpretimit të provave dhe jo shkeljeve ligjore procedurale ose materiale dhe, si i tillë, nuk duhet të ishte bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Është pikërisht ky roli i Gjykatës



së Lartë, si gjykatë ligji, e cila nuk ka gjetur elemente të natyrës ligjore, por ka bërë një analizë të mirëfilltë fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin procedural.

8.2. Parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar, pasi Gjykata e Lartë ka rishqyrtuar themelin e çështjes tashmë të gjykuar nga gjykata e arbitrazhit. Dispozitivi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit është i qartë dhe i vetëzbatueshëm, dhe asnjë gjykatë nuk mund të ushtrojë kompetencë për të interpretuar rrethanat faktike ose dokumentet kontraktuale mbi të cilat është mbështetur vendimi. Për më tepër, ajo ka kërkuar verifikimin e metodologjisë së ndjekur nga gjykata e arbitrazhit për llogaritjen e detyrimit financiar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka kryer një shqyrtim të përmbytjes së kontratës, e cila përbënte objekt të drejtpërdrejtë të procesit të arbitrazhit dhe është analizuar nga kjo e fundit në kuadër të kompetencës së saj ekskluzive. Ndërkohë që gjykimi ka në thelb procedurat e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, në të cilat nuk lejohet rishqyrtimi i themelit të detyrimit ose përcaktimi i masës së tij. Në rastin konkret, orientimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, një dispozitë ligjore urdhëruese, e cila në mënyrë eksplicite ndalon shqyrtimin, vlerësimin ose analizën e një titulli ekzekutiv (vendim gjyqësor ose arbitrazhi) për fakte të mëhershme se dhënia e vendimit.

8.3. Gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se Gjykata e Lartë ka vepruar jashtë afateve ligjore për shqyrtimin e rekursit, duke shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 60 të ligjit nr. 49/2012, pasi vendimi është marrë në datën 19.2.2025, ndërkohë që rekursi është paraqitur në datën 11.12.2023.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Në datën 29.10.2025 kërkesja që ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, nëpërmjet administratorit, ka paraqitur kërkesë, me objekt: “Heqje dorë nga kërkesa”, në të cilën ka parashtruar se: “Në zbatim të së drejtës së kërkuarës për disponimin mbi kërkesën e paraqitur sipas nenit 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, kërkesja shoqëria “Vega” sh.a., ju drejtohet, duke kërkuar: Heqjen dorë nga kërkesa e shoqërisë “Vega” sh.a. regjistruar pranë Gjykatës Kushtetuese më 10.6.2025,

nr. Regj. Them., 6 (V), me objekt: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Prishja/shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1831 (83), datë 19.2.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 831 (86-2023-1153), datë 6.11.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit.”. Kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 29.10.2025 dhe u është komunikuar të gjitha palëve pjesëmarrëse në gjykim/subjekteve të interesuara, të cilat nuk kanë paraqitur prapësime në lidhje me të.

10. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pika 2, të Kushtetutës, dhe nenit 71, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, përfshihen edhe personat juridikë, sikurse shoqëria tregtare në këtë gjykim. Ndërsa neni 31/b i ligjit nr. 8577/2000 parashikon të drejtën e kërkuarës për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Heqja dorë nga kërkesa nuk pranohet kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik. Ndërsa pika 2 e nenit 43/b të po këtij ligji, që parashikon të drejtat e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, ia njeh këtë të drejtë kërkuarës në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

11. Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata evidenton se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkuarës i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky i fundit, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik.

12. Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet të analizojë nëse shqyrtimi i çështjes konkrete mbart interes publik, në kuptimin që të zbatohet rregulli përjashtimor i parimit të disponibilitetit. Nga përmbytja e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor, në të cilin kërkuarësja ka qenë palë ndërgjyqëse në cilësinë e palës së paditur. Kërkuarësja ka pretenduar se asaj i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u



gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

13. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimin për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkuar në këtë rast janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetuese dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

#### VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimin të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 17.11.2025.**

**Shpallur më 26.11.2025.**

**Kryesuese:** Marsida Xhaferllari

**Anëtarë:** Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

#### VENDIM

**Nr. 795, datë 18.11.2025**

#### PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të neneve 147 dhe 147/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 9 dhe 174, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

#### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Papajtueshmëritë me funksionin e gjyqtarit

1. Funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me çdo veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe me çdo veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës.

2. Përjashtimisht, gjyqtari mund të ushtrojë veprimtari mësimdhënëse, akademike ose shkencore, me kusht që këto veprimtari të mos cenojnë ushtrimin e funksioneve gjyqësore.

#### Neni 2

#### Objekti

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit nga gjyqtari në detyrë, gjyqtari i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe ndihmësi magjistrat në Gjykatën e Lartë.

2. Nga zbatimi i këtij vendimi përjashtohet gjyqtari i komanduar pranë institucioneve të tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen edhe për gjyqtarin e pezulluar nga detyra, me përjashtim të rasteve kur pezullimi është i lidhur me ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit.

#### Neni 3

#### Përkufizime

1. Në zbatim dhe për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Veprimtari jashtë funksionit” nënkupton çdo veprimtari, të paguar ose të papaguar, që nuk përfshihet në veprimtarinë gjyqësore ose administrative të ushtrimit të funksioneve gjyqësore. Kjo përfshin aktivitetet mësimdhënëse, akademike dhe shkencore, të realizuara nëpërmjet shkrimeve, publikimeve, këshillimeve, mbajtjes së leksioneve për çështje ligjore, si dhe pjesëmarrjes në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor ose administrimin e drejtësisë.



b) “Aktivitet mësimdhënës”, nënkupton punën që kryen gjyqtari me qëllim krijimin, zhvillimin, përcjelljen dhe mbrojtjen e njohurive në institucionet e arsimit të lartë ose në institucionet që kontribuojnë në formimin profesional.

c) “Aktivitet shkencor”, nënkupton çdo veprimtari kërkimore sistematike që synon zbulimin e njohurive të reja dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ky aktivitet mund të ushtrohet në formën e kërkimit shkencor-bazë ose atij të zbatuar dhe ka për qëllim përdorimin nga publiku i gjerë.

ç. “Aktivitet akademik” nënkupton çdo aktivitet mësimdhënës dhe kërkimor-shkencor që zhvillohet pranë institucioneve të arsimit të lartë.

d) “Veprimtari e paguar jashtë funksionit”, nënkupton çdo veprimtari mësimdhënëse, akademike ose shkencore, për të cilën përfitohet pagesë, shpërblim financiar ose çdo formë tjetër kompensimi.

dh) Këshilli” nënkupton Këshillin e Lartë Gjyqësor.

e) “Mbledhje plenare” nënkupton mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

ë) “Komisioni” nënkupton Komisionin e Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

#### Neni 4

### **Kushtet për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit**

1. Gjyqtari lejohet të ushtrojë veprimtari jashtë funksionit vetëm nëse kjo veprimtari plotëson njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, me reputacionin e organeve të sistemit të drejtësisë dhe me besimin e publikut në sistemin gjyqësor;

b) është në përputhje me standardet e etikës dhe me rregullat e sjelljes së gjyqtarit;

c) nuk krijon perceptime të ndikimit, varësisë apo njëanshmërisë gjatë ushtrimit të funksionit;

ç) nuk bie ndesh me interesat thelbësore të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve gjyqësore;

d) nuk bie ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;

dh) shpërblehet në përputhje me rregullat e zakonshme të tregut;

e) nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe nuk përbën veprimtari të ndaluar, sipas neneve 6 dhe 7 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 5

### **Mënyra dhe koha e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit**

1. Gjyqtari mund të ushtrojë veprimtari jashtë funksionit vetëm në masën që kjo veprimtari nuk cenon përmbushjen me efektivitet të detyrave gjyqësore dhe nuk ndërhyr në respektimin e orarit të punës.

2. Ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit lejohet vetëm në kufijtë kohorë të arsyeshëm, të tillë që të sigurojnë ruajtjen e balancës ndërmjet angazhimit profesional dhe zhvillimit akademik, pa ndikuar në cilësinë dhe përmbushjen e detyrimeve gjyqësore.

3. Gjyqtari merr masa që ushtrimi i veprimtarive jashtë funksionit të shpërndahet në mënyrë të përshtatshme gjatë vitit kalendarik, pa e kryer në mënyrë të pandërprerë dhe pa ndikuar në funksionimin normal të gjykatës.

4. Koha e përdorur për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit nuk përbën leje të paguar ose të papaguar në kuptim të neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### KREU II

### **VEPRIMTARIA E PAGUAR JASHTË FUNKSIONIT**

#### Neni 6

### **Paraqitja e kërkesës**

1. Gjyqtari mund të ushtrojë veprimtari të paguar jashtë funksionit vetëm pas miratimit të kërkesës së tij nga Këshilli.

2. Komisioni është përgjegjës për administrimin e procedurës, shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për lejimin ose jo të ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit.

3. Gjyqtari paraqet kërkesën për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, sipas modelit bashkëlidhur në aneksin nr. 1 të këtij vendimi.



4. Kërkesa përmban këto të dhëna:

- a) të dhënat e gjyqtarit;
- b) gjykatën ku ushtron funksionin ose institucionin ku është i komanduar;
- c) përshkrim të detajuar të veprimtarisë jashtë funksionit që kërkohet të ushtrohet;
- ç) institucionin ose organizatën pranë së cilës do të zhvillohet veprimtaria.

Neni 7

### Dokumentacioni shoqërues

1. Kërkesës për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit i bashkëlidhet dokumentacioni shoqërues që përmban:

- a) numrin e çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;
- b) numrin e çështjeve të gjykuara në vitin e mëparshëm kalendarik;
- c) numrin e çështjeve të mbartura në vitin gjatë të cilit paraqitet kërkesa;
- ç) numrin e çështjeve të gjykuara tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399 të Kodit të Procedurës Civile;
- d) të dhëna mbi uljen në ngarkesë, nëse gjyqtari ka përfituar, si dhe arsyet e përfitimit;
- dh) mesataren e ngarkesës në gjykatë;
- e) burimin e financimit dhe masën e shpërbllimit;
- ë) periudhën dhe numrin e orëve të parashikuara për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit.

Neni 8

### Shqyrtimi i kërkesës

1. Pas paraqitjes së kërkesës për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, Komisioni cakton me short një relator për shqyrtimin e saj.

2. Kur relatori konstaton se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose nuk mundëson marrjen e një vendimi, ai njofton gjyqtarin për plotësimin e tij. Në këtë rast, afati për shqyrtimin e kërkesës fillon nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotësuar.

3. Relatori, kur e çmon të nevojshme, mund të kërkojë informacion shtesë nga institucione të tjera ose nga vetë gjyqtari kërkues.

4. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, relatori përgatit projektaktin përkatës dhe ia paraqet Komisionit për vendimarrje.

Neni 9

### Vendimarrja e Komisionit

1. Komisioni merr vendim brenda afatit trejavor nga paraqitja e kërkesës ose nga momenti i plotësimit të saj me të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar. Vendimi merret me shumicë të votave të anëtarëve të Komisionit.

2. Vendimi i arsyetuar i Komisionit i komunikohet gjyqtarit kërkues, sipas parashikimeve të nenit 98, pika 1 të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Një kopje e vendimit të miratimit i dërgohet për dijeni kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin ose drejtuesit të institucionit ku gjyqtari është i komanduar.

3. Nëse Komisioni brenda tre javëve nga paraqitja e kërkesës ose plotësimi i dokumentacionit, nuk merr vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës, kërkesa konsiderohet e miratuar.

4. Komisioni mund të shfuqizojë vendimin për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit në qoftë se provohet se gjyqtari është duke ushtruar veprimtarinë në tejkalim të kushteve për të cilat është dhënë miratimi, ose në kundërshtim me kushtet e ushtrimit të veprimtarisë. Për shfuqizimin e vendimit, ndiqet, për aq sa është e mundur, procedura e njëjtë si për shqyrtimin e kërkesës.

5. Kundër vendimit të refuzimit ose të shfuqizimit, gjyqtari ka të drejtën e ankimit në Mbledhjen Plenare sipas nenit 99 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Neni 10

### Regjistrimi i veprimtarive jashtë funksionit

1. Vendimi i Komisionit ose Këshillit për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit, përfshihet në dosjen personale të gjyqtarit.

2. Pranë Këshillit krijohet një regjistër elektronik i veçantë që përmban të dhëna mbi ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit.





KREU III  
VEPRIMTARIA E PAPAGUAR JASHTË  
FUNKSIONIT

Neni 11  
**Ushtrimi i veprimtarisë të papaguar jashtë  
funksionit**

1. Gjyqtari mund të ushtrojë veprimtari të papaguara jashtë funksionit pa miratimin paraprak të Këshillit, vetëm kur:

- a) vepron si përfaqësues i gjykatës ose gjyqësorit;
- b) merr pjesë në aktivitete që lidhen me sistemin gjyqësor ose administrimin e drejtësisë;
- c) merr pjesë në diskutime për çështje ligjore.

2. Para ushtrimit të veprimtarive të papaguara jashtë funksionit, gjyqtari mund të kërkojë mendimin e Këshilltarit të Etikës lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. Këshilltari i Etikës i kthen përgjigje brenda një afati treditör.

3. Gjyqtari, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës, duhet të dërgojë pranë Këshillit një raport me shkrim mbi veprimtaritë e papaguara të ushtruara gjatë vitit paraardhës. Raporti përmban llojin dhe natyrën e veprimtarisë së ushtruar pa pagesë, si dhe kohëzgjatjen e saj brenda orarit zyrtar.

KREU IV  
MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Neni 12  
**Monitorimi dhe përgjegjësitë disiplinore**

1. Komisioni monitoron ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarit.

2. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë, pa miratim të Këshillit, përbën shkak për procedim disiplinor sipas nenit 103, shkronja “c”, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në raportimin vjetor që Komisioni përgatit për Mbledhjen Plenare, përfshihen edhe gjetjet dhe

rekomandimet për veprimtaritë jashtë funksionit të gjyqtarëve.

Neni 13  
**Raportimi dhe publikimi i veprimtarive  
jashtë funksionit**

1. Këshilli, brenda muajit janar të çdo viti, publikon në faqen zyrtare listën e gjyqtarëve të miratuar për veprimtari të paguara jashtë funksionit për vitin paraardhës. Lista përmban emrin e gjyqtarit, vendin ku ushtron funksionin dhe institucionin ose organizatën ku është ushtruar veprimtaria.

2. Këshilli brenda muajit janar të çdo viti i përcjell Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave, si dhe organeve tatimore, një raport me shkrim mbi veprimtaritë e paguara jashtë funksionit të ushtruara nga gjyqtarët gjatë vitit paraardhës. Raporti përfshin pagesën ose shpërblimin e përfituar dhe vlerën normale të tregut për veprimtari të njëjtë.

KREU V  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14  
**Dispozitë kalimtare**

1. Vendimet për ushtrimin e veprimtarive të paguara jashtë funksionit, të miratuara në heshtje, për shkak të kalimit të afatit trejavor para miratimit të këtij vendimi, mbeten në fuqi deri në përfundim të afatit ose të veprimtarisë për të cilën janë miratuar.

Neni 15  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR  
KRYETARI  
**Ilir Rusi**



## ANEKSI 1

## KËRKESE

## PËR LEJIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË PAGUAR JASHTË FUNKSIONIT

**Drejtuar:** Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale  
pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor

**Të dhënat e gjyqtarit:**

- Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_
- Atësia: \_\_\_\_\_
- Datëlindja: \_\_\_\_\_
- Adresa e kontaktit: \_\_\_\_\_
- E-mail: \_\_\_\_\_
- Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

**Të dhënat profesionale:**

- Gjykata ku ushtron funksionin/institucioni ku është i komanduar: \_\_\_\_\_

**Përshkrimi i veprimtarisë jashtë funksionit që kërkohet të ushtrohet:**

- Lloji i veprimtarisë (mësimdhënëse, akademike, shkencore): \_\_\_\_\_
- Përshkrim i detajuar i veprimtarisë: \_\_\_\_\_
- Institucioni/organizata pranë së cilës do të zhvillohet veprimtaria: \_\_\_\_\_
- Periudha e zhvillimit të veprimtarisë (data fillimit dhe përfundimit): \_\_\_\_\_
- Numri i parashikuar i orëve në javë/muaj: \_\_\_\_\_
- Masa e shpërblimit: \_\_\_\_\_

**Të dhënat statistikore mbi ngarkesën e punës:**

- Numri i çështjeve në shqyrtim: \_\_\_\_\_
- Numri i çështjeve të gjykuara në vitin e kaluar: \_\_\_\_\_
- Numri i çështjeve të mbartura: \_\_\_\_\_
- Numri i çështjeve të gjykuara tej afatit të arsyeshëm (sipas nenit 399 të K. Pr. Civile): \_\_\_\_\_
- Ulje në ngarkesë (po/jo). Nëse po, shënohet arsyeja: \_\_\_\_\_
- Mesatarja e ngarkesës në gjykatë: \_\_\_\_\_

**Deklaratë e gjyqtarit:**

Në përputhje me nenin 4, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit”, deklaroj se veprimtaria e kërkuar është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, me reputacionin e organeve të sistemit të drejtësisë, si dhe me **standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes** së gjyqtarit. Gjithashtu, konfirmoj se kjo veprimtari **nuk krijon perceptime të ndikimit, varësisë apo njëanshmërisë, nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit dhe nuk cenon përmbushjen me efektivitet të detyrave gjyqësore.**

**Data:** \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_



## VENDIM

Nr. 285, datë 13.11.2025

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN TETOR 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2768/1 prot., datë 4.11.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

**I. Aspektet ligjore dhe procedurale****1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.**

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 5832 prot., datë 31.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2768 prot., datë 3.11.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin tetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

**2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE**

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

**II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV****1. Blerja e energjisë në bursë**

Për muajin tetor 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

**2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBET)**

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin tetor 2025, në vlerën 12.76 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 12.76 lekë/kwh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

**3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)**

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBET)** për muajin tetor 2025: **12.76 lekë/kwh;**

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kwh;**

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kwh;**

- **Kostot administrative:** **1.06 lekë/kwh;**

- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **30.9.2025–30.10.2025.**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, përlogaritet, si më poshtë:



**Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin tetor 2025**

|                                                                 | Njësia          | Çmimi        |
|-----------------------------------------------------------------|-----------------|--------------|
| CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike | Lekë/kWh        | 12.76        |
| Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)   | Lekë/kWh        | 0.38         |
| CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit   | Lekë/kWh        | 1.06         |
| TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit              | Lekë/kWh        | 0.85         |
| TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes             | Lekë/kWh        | 1.55         |
| <b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA</b>   | <b>Lekë/kWh</b> | <b>16.60</b> |

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 16.60 lekë/kwh për muajin tetor 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDIM**

**Nr. 286, datë 13.11.2025**

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË  
SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY”  
SHPK NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, prej 16.60 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR  
Petrit Ahmeti**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13, 16 dhe 14, pika 9, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2516/6 prot., datë 7.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2516/1 prot., datë 16.10.2025, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 27.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.



- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2025 dhe 29.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 6.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2515/4 prot., datë 29.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin, që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2516/5 prot., datë 4.11.2025, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s, si dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

- Rezulton se shoqëria disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i marrëveshjes së huapërdorjes nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet t’i lihet kusht depozitimi brenda datës 29.7.2027, i marrëveshjes së rinovuar për përdorimin e zyrave ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 17.4.2026.

2. Brenda datës 29.7.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 287, datë 13.11.2025

#### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFOTELECOM-ALBSOLAR 4” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2207/16 prot., datë 10.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Infotelecom-Albsolar 4’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207 prot.,



datë 30.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 191, datë 12.8.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.8.2025 dhe 14.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 11.9.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2207/3 prot., datë 14.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar, ose të plotësuar pjesërisht.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2207/4 prot., datë 14.8.2025, ku po ashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/5 prot., datë 9.9.2025, ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është parë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore për arsye të sqarimit të mëtejshëm të dokumentacionit të munguar. Ndaj ERE me shkresën nr. 2207/7 prot., datë 17.9.2025, i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar zhvillimin e seancës dëgjimore.

- Në datën 22.9.2025 është zhvilluar seanca dëgjimore në ambientet e ERE-s ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., të cilët, në vijim të seancës morën angazhimin për të plotësuar dokumentacionin e munguar, brenda afatit të përcaktuar.

- Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 2207/8, datë 24.9.2025, shoqëria i është drejtuar MIE-s, duke vënë në dijeni ERE-n, në lidhje me

marrijen e konfirmimit zyrtar, apo shkresë formale mbi nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare dhe Marrëveshjes së Mbështetjes nga MIE. Duke qenë se ky *e-mail* nuk shteronte sa kërkohet dhe marrë angazhim nga shoqëria gjatë seancës dëgjimore, ERE i është drejtuar me *e-mail*-in me nr. 2207/9 prot., datë 1.10.2025, duke i bërë me dije sa më sipër, si dhe duke i rikujtuar detyrimin për depozitimin e dokumentacionit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/10 prot., datë 1.10.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit, nga analizimi i të cilit rezultoi se ishte ende i nevojshëm zhvillim i një komunikimi të mëtejshëm mbi dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.

- Si e tillë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 14.10.2025, vendosi të zgjasë vendimmarrjen për licencimin e shoqërisë. Ky vendim iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE me nr. 2207/12 prot., datë 20.10.2025, me anë të së cilës i është kërkuar dhe depozitimi i dokumentacionit të sipërcituar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/13 prot., datë 27.10.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, nga analizimi i të cilit u pa i nevojshëm zhvillimi i një komunikimi të mëtejshëm, në lidhje me nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare me MIE-n, ndaj ERE-s iu drejtua përsëri shoqërisë nëpërmjet *e-mail*-it nr. 2207/14 prot., datë 4.11.2025.

- Së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/15 prot., datë 4.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion dhe informacion, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

**Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:**

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit



fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 35,6 mwac dhe Kapacitet të Mbështetur 35,6 mwac, që do të vendoset në Bashkinë Bulqizë, rruga ‘Gjoricë e Poshtme’, Shqipëri”, të datës 4.12.2024.

- Ka nënshkruar “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetit e transmetimit të parkut fotovoltaik “Gjorica Solar Park”, me OST sh.a., datë 29.7.2025.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 17.9.2025, për të zhvilluar projektin: “Projekti fotovoltaik Gjorica Solar Park 40 mw”, me vendndodhje në Bashkinë Bulqizë. Kjo VNM është e vlefshme deri më 17.9.2027.

#### **Kushtet dhe afatet ligjore**

ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Rezulton se shoqëria ka nënshkruar marrëveshjen e zhvillimit me MIE-n dhe nuk ka nënshkruar ende marrëveshjen përfundimtare, ndaj, referuar vetë parashikimit të shoqërisë që do të vendosë në operim centralin më datë 1.10.2026, vlerësohet që t’i lihet asaj kusht që të raportojë në ERE, në lidhje me ecurinë e nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare brenda dhe të fillojë operimin brenda datës së parashikuar nga ana e saj.

- Po ashtu, në referencë të sa parashikohet në pikën 6.8 të marrëveshjes së zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Brenda datës 1.10.2026, shoqëria duhet të raportojë në ERE, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare me MIE-n dhe të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR  
Petrit Ahmeti**



## VENDIM

Nr. 288, datë 13.11.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT  
TË ERE-s NR. 197, DATË 15.8.2025, “MBI  
LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘KËLCYRA  
2020’ SHPK NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC ‘KLISYRË’, ME  
KAPACITET PRODHUES 2 mw”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve, 77–89 dhe 113 ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2038/17 prot., datë 11.11.2025, të drejtorive teknike të ERE-s “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyra 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Klisyrë’, me kapacitet prodhues 2 mw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 17.7.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Këlcyra 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë. Ky vendim i është njoftuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 2038/4 prot., datë 23.7.2025.

- Në vijim të plotësimit të dokumentacionit/informacionit të munguar nga ana e shoqërisë dhe në rrethanat që nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë kthim përgjigjeje, me vendimin nr. 197, datë 15.8.2025, Bordi i ERE-s vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Këlcyra 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë, për një afat 30-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, për kapacitetin 2 mw.

3. Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE ndërtimin dhe vënien në punë të HEC-it brenda datës 31.12.2025.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. Brenda datës 1.1.2026, shoqëria duhet të depozitojë marrëveshjen e rinovuar për shërbimet e kontabilitetit.

6. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës nr. 2038/9 prot., datë 18.18.2025, dhe palëve të interesit nëpërmjet shkresës nr. 2038/11 prot., datë 20.8.2025.

- Në të njëjtën ditë, në ERE është administruar shkresa e MIE-s nr. 5331/1 prot., datë 19.8.2025, protokolluar në ERE me nr. 2038/10 prot., datë 20.8.2025, me anë të së cilës, MIE ka bërë me dije se shoqëria “Këlcyra 2020” sh.p.k. i është drejtuar asaj me shkresën e datës 21.3.2025, me kërkesën për pajisje me faturën e pagesës referuar VKM-së nr. 822/2025, të ndryshuar, me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar për zgjerimin e kapaciteti të hidrocentralit ekzistues Këlsyrë, i privatizuar nga ana e saj. Në përgjigje të kësaj kërkeje, MIE njofton se me shkresën e saj nr. 2462/1 prot., datë 24.4.2025, i ka bërë me dije shoqërisë, se me ligjin nr. 61/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar”, në pikën 2 të nenit 49 të ligjit nr. 43/2015, është përcaktuar se miratimi për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë bëhet nëpërmjet një procesi konkurrues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër, MIE sjell në vëmendje të ERE-s se ajo nuk ka miratuar zgjerimin e kapacitetit të hidrocentralit ekzistues Këlsyrë, i privatizuar nga ana e shoqërisë “Këlcyra 2020” sh.p.k..

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 2038/12 prot., datë 22.8.2025, ka njoftuar shoqërinë se është vënë në dijeni të qëndrimit të MIE-s si më sipër, si e tillë, përpara se të vijohet me rishikimin e vendimit nr.





197/2025, shoqëria duhet të depozitojë qëndrimin e saj dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me sa më sipër.

- Po ashtu, me shkresën nr. 2038/13 prot., datë 22.8.2025, ERE i është drejtuar MIE-s duke i bërë me dije se ERE tashmë ka vijuar me licencimin e shoqërisë, sipas kushteve përkatëse dhe në kushtet kur ERE është vënë tashmë në dijeni të korrespondencës së zhvilluar mes shoqërisë dhe MIE-s dhe qëndrimit të kësaj të fundit, do të vijohet me rishikimin e këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038/14 prot., datë 28.8.2025, shoqëria është shprehur se, në referencë të ligjit nr. 43/2015, MIE jep autorizime nëpërmjet procesit konkurrues vetëm për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, ndaj në rrethanat që shoqëria ka privatizuar një HEC ekzistues, nuk i nënshtrohet këtij procesi.

- Me shkresën nr. 2038/15 prot., datë 9.9.2025, ERE i është drejtuar sërish MIE-s, duke vënë në këtë shkresë për dijeni dhe shoqërinë, dhe dukë kërkuar nga MIE qëndrimin e saj në lidhje me sa parashtrohet nga shoqëria me shkesën e sipërcituar, përpara se ERE të vijojë me rishikimin e vendimit.

- Së fundi, me shkresën nr. 5331/4 prot., datë 9.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2038/16 prot., datë 14.10.2025, MIE është shprehur se qëndrimi i saj mbetet i pandryshuar nga ai i shprehur më parë, duke evidentuar se në referencë të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar, miratimi për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë bëhet nëpërmjet procesit konkurrues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

- Me marrjen e qëndrimit të MIE-s, një dokument që nuk disponohej përpara se ERE të vijonte me vendim marrjen përfundimtare për licencimin e shoqërisë, vlerësohet se jemi në rrethanat e rishikimit të vendimit të Bordit nr. 197/2025, ku në pikën 6 të tij është parashikuar se ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Vlerësohet të sqarohet se fillimi i pasojave juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197/2015, sa i përket fillimit të ushtrimit të së drejtës për prodhimin e energjisë elektrike, ishte i kushtëzuar me pajisjen nga ana e shoqërisë edhe

depozitimin në ERE nga ana e saj të lejes së përdorimit të burimit ujor, çka përbën një dokument thelbësor për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Duke qenë se nuk rezulton të jetë depozituar nga ana e shoqërisë ky dokument, ky kusht ndalues është aktualisht në fuqi dhe licenca për prodhimin e energjisë elektrike nuk e ka filluar ende efektshmërinë e saj.

Për sa më sipër, në referencë të përcaktimeve të nenit 77 e në vijim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me hetimin administrativ, për sa parashikohet dhe në pikën 6 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, vlerësohet të fillohet procedura për rishikimin e këtij vendimi, me qëllim vlerësimin e fakteve dhe të rrethanave të nevojshme që lidhen me aplikimin shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe objektin e kërkesës së këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197/2025, datë 15.8.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyrë 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 mw”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Këlcyrë 2020” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 289, datë 13.11.2025****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1849/17 prot., datë 11.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1849 prot., datë 11.6.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 124, datë 24.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.6.2025 dhe 26.6.2025) dhe, në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 4.7.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1849/3 prot., datë 2.7.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, si dhe i ka kërkuar të bëjë me dije mbi nënshkrimin e

Kontratës me shoqërinë, duke qenë se shoqëria ka depozituar vetëm miratimin paraprak të MIE-s. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 1849/4 prot., datë 2.7.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1849/5 prot., datë 14.7.2025, ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, e në vijim, me *e-mail*-in e po së njëjtës ditë, të protokolluar me nr. 1849/6 prot., ka kërkuar pezullimin e procedurës së licencimit, me 45 ditë, pasi ende nuk dispononte kontratën me MIE-n.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 160, datë 18.7.2025, vendosi të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me 45 ditë. ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1849/8 prot., datë 23.7.2025, duke i vënë në dukje detyrimin që shoqëria ka për të depozituar dokumentacionin e munguar brenda afatit të përcaktuar. Ky detyrim i është rikujtuar shoqërisë nëpërmjet *e-mail*-it të ERE-s të datës 25.8.2025.

- Në përgjigje, me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1849/10 prot., datë 29.8.2025, shoqëria ka bërë me dije se kërkesa e tyre për pezullim, përkoji me muajin gusht, ku institucionet kanë qenë pushim gjatë këtij muaji, ndaj dhe nënshkrimi i Kontratës ka qenë i pamundur për shoqërinë. Për këtë arsye, shoqëria ka kërkuar që ERE të pezullojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., për një afat të pacaktuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 211, datë 9.9.2025, vendosi të ndryshojë vendimin nr. 160/2025 dhe të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin nga ana e saj të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 1849/12 prot., datë 10.9.2025.

- Me *e-mail*-in e datës 30.10.2025, shoqëria ka depozituar në format elektronik kontratën e nënshkruar me MIE-n. Kjo kontratë është depozituar në ERE në formatin e njëzuar me origjinalin më datë 3.11.2025.

- Me *e-mail*-in me nr. 1849/15 prot., datë 7.11.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i



sjellë në vëmendje se nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga ana e saj, afati i licencës së prodhimit do të jetë për 25 vjet. Si e tillë, në rast të saktësimit të kërkesës për afatin e licencimit, ajo duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës.

- Në përgjigje, me *e-mail*-in e datës 10.11.2025, ka saktësuar se afati i kërkuar nga ana e saj për licencim është për një periudhë 30-vjeçare dhe me *e-mail*-in e së njëjtës ditë, të protokolluar në ERE me nr. 1849/16 prot., datë 10.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin përkatës shtesë.

- Për gjithë sa më sipër, me depozitimin e kontratës së nënshkruar me MIE-n, sikur referuar në vendimin nr. 160/2025, rezulton se shkaku i pezullimit ka rënë, e në kuadër të sqarimeve dhe të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria në vijim, vlerësohet të vijohet me vendimmarrjen përfundimtare për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

#### **Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime te tjera:**

- Shoqëria është pajisur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.9.2025, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘IDI 2005’ sh.p.k.”.

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën e datës 29.10.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 8.8 mw, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘IDI 2005’ sh.p.k.”.

- Me shkresat e “OSSH” sh.a., nr. 2143/3 prot., datë 12.3.2024, dhe nr. 3554/1 prot., datë 11.4.2024,

është miratuar pika e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes.

- Shoqëria është pajisur me vendimin për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) më 7.11.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 8.8 mw.

#### **Kushtet dhe afatet ligjore:**

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria vetë ka parashikuar se jetëgjatësia e centralit është 25–30 vjet dhe nga garancia e paneleve që ajo parashikon të përdorë rezulton se ato kanë një jetëgjatësi prej 25–30 vitesh. Po ashtu, në planin e biznesit ajo ka parashikuar se jetëgjatësia ekonomike është 25 vjet, ndaj në rrethana të tilla vlerësohet që dhe afati i licencës të jetë për 25 vjet.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme deri në datën 7.11.2026 dhe ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda datës 30.12.2026. Referuar VKM-së nr. 534, datë 25.9.2025 dhe kontratës së datës 29.10.2025, shoqëria duhet të ndërtojë dhe të vendosë në operim centralin brenda datës 25.9.2028, ndaj vlerësohet që t’i lihet asaj detyrë për të filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda këtij afati.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës. ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të dokumentacionit sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



## VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 25.9.2028.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrir Ahmeti

## VENDIM

Nr. 292, datë 13.11.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST  
SHA PËR MIRATIMIN E “KODIT TË  
RRJETIT MBI EMERGJENCËN DHE  
RIVENDOSJEN”**

Në mbështetje të neneve 16, 20, geramat “a”, 23, pika 1, germa “b”, 30, pika 2, dhe 90, pika 3, të ligjit  
Faqe | 28086

nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2159/1 prot., datë 24.10.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196 e 24 nëntor 2017, ‘Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen’”,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 2903 prot., datë 26.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1739 prot., datë 30.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196, datë 24.11.2017, ‘Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen’”.

- Në këtë kërkesë, OST sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datës 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.

- Rregullorja (BE) 2017/2196, e njohur si Kodi i Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen, vendos një kornizë të harmonizuar për menaxhimin e situatave emergjente dhe procedurat e rivendosjes së sistemeve të transmetimit në nivel rajonal dhe evropian, duke përcaktuar rregulla të detajuara për operatorët e sistemeve të transmetimit dhe strukturat rajonale të koordinimit të sigurisë. Qëllimi i saj është të sigurojë operimin e sigurt, stabilitetin dhe rikuperimin e sistemit elektroenergjetik në raste emergjencash.

- Rregullorja përcakton rregulla të qarta dhe të detajuara për operatorët e sistemeve të transmetimit, lidhur me menaxhimin e emergjencave, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale, si dhe koordinimin e veprimeve për rivendosjen e sistemit pas ndërprerjeve, incidenteve ose kontigjencave.

- Gjithashtu, kjo rregullore përmban kërkesa të detajuara për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme në sistemin elektroenergjetik. Ajo synon të sigurojë që sistemet elektroenergjetike të mbeten të qëndrueshme dhe të rikuperueshme në



rast emergjencash ose kolapsesh të plota (*blackout*), nëpërmjet një qasjeje të koordinuar në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe të konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

- Nëpërmjet *email*-it të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 24.7.2025, janë përcjellë pranë ERE-s komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në kuadër të procesit të miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Këto komente kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për mënyrën e transpozimit të udhëzimeve dhe rregulloreve të Paketës së Energjisë së Pastër, përfshirë aktet mbi balancimin (EBGL), alokimin afatgjatë të kapaciteteve (FCA), si dhe operimin e sistemit (SOGL) dhe emergjencat dhe rikuperimin (NC ER).

- Në vijim të komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 24.7.2025, vlerësohet se këto sugjerime kanë rëndësi të veçantë për qasjen e ndjekur nga ERE në transpozimin e Kodit të Rrjetit dhe Udhëzimeve të Tregut, përfshirë rregulloren në fjalë. Komentet theksojnë nevojën që detyrimet që rrjedhin për OST sh.a., NEMO dhe autoritetet rregullatore të jenë të përcaktuara qartë në nivelin përkatës ligjor, si dhe të sigurohet koordinim i plotë me dispozitat mbi ACER-in, metodologjitë e përbashkëta (TCMs), çështjet ndërkufitare dhe qendrat rajonale të koordinimit (RCC).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 293, datë 13.11.2025

#### MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 93, DATË 28.4.2025, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE DHE MENAXHIMIT TË KONGJESTIONEVE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 2829 prot, datë 11.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.4.2025, “Mbi miratimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 28.4.2025, miratoi “Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Kongjestioneve (CACM)”, e cila transponon rregulloren (BE) 2015/1222, në zbatim të vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

- Vendimi nr. 93/2025 u botua në Fletoren Zyrtare nr. 92, datë 29.5.2025, duke përcaktuar se rregullorja hyn në fuqi pas botimit.



### 1. Komunikimi dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

- Sekretariati, me komunikimin elektronik të datës 14.2.2025, përcolli qëndrimet dhe rekomandimet mbi procesin e miratimit të Rregullores CACM, duke vlerësuar nevojën për saktësimin e aplikueshmërisë së saj për Republikën e Shqipërisë dhe përshtatjen e dispozitave me kompetencat kombëtare të ERE-s, OST sh.a. dhe ALPEX-it.

- Në të njëjtin komunikim, Sekretariati theksoi se miratimi i rregullores nga ERE, përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri sektorial, ka efekt të kufizuar praktik, pasi zbatimi i plotë i saj kërkon transpozimin e Paketës së Integritetit të Energjisë Elektrike dhe konfirmimin e përputhshmërisë nga Sekretariati.

### 2. Zhvillimet ligjore dhe institucionale

- Faza e konsultimit publik për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’”, u zhvillua gjatë periudhës 1.7.2025–29.7.2025. Ky projektligj synon harmonizimin e legjislacionit bazë me Paketën e Energjisë së Pastër (*Clean Energy Package*) dhe përcaktimin e rolit institucional të ERE-s, OST sh.a. dhe ALPEX-it në proceset e bashkimit të tregjeve.

- Në këtë kuadër, konsiderohet e nevojshme që hyrja në fuqi e rregullores CACM të sinkronizohet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri sektorial, për të siguruar koherencë juridike dhe zbatim efektiv.

### 3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, një akt administrativ mund të ndryshohet, ose të shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, kur paraqiten rrethana të reja ligjore ose faktike.

- Në rastin konkret, për shkak të zhvillimeve ligjore që lidhen me procesin e miratimit të ligjit të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, vlerësohet e arsyeshme shtyrja e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 93/2025 deri më datë 1 korrik 2026, për të siguruar që zbatimi i rregullores të bëhet mbi një bazë ligjore të përditësuar.

### 4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Shtyrja e hyrjes në fuqi nuk përbën ndryshim material të përmbajtjes së rregullores CACM, por vetëm harmonizim të efekteve të saj juridike me kuadrin ligjor në zhvillim.

- Ky ndryshim garanton siguri juridike, parashikueshmëri dhe përputhshmëri me

rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 93, datë 28.4.2025, bëhet ndryshimi si vijon: “Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2026”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

### VENDIM

Nr. 295, datë 17.11.2025

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQATËS “TAKSITË E KLASIT TË PARË” DHE SINDIKATËS SHQIPTARE TË TAKSIVE PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 255, DATË 15.10.2025, “MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT, ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kw”**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “ë”, dhe 81, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 144 dhe 146, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16, pika 5, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-



s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2732/2 prot., datë 13.11.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesave të Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe të Sindikatës Shqiptare të Taksive për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025, Bordi i ERE-s ka vendosur ndër të tjera; miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 22 lekë/kwh për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet me fuqi të instaluar mbi 11 kw dhe aplikimin e çmimit të diferencuar në orarin e pikut, me hyrje në fuqi nga data 1 nëntor 2025.

- Me datë 23.10.2025, ERE-s dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i janë drejtuar dy kërkesa të veçuara nga Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikata Shqiptare e Taksive”, të cilat kundërshtojnë vendimin e Bordit nr. 255, datë 15.10.2025, duke kërkuar: 1. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të tarifës së re deri në zhvillimin e një dëgjimi publik me Shoqatën dhe grupet e tjera të interesit; 2. Rishikimin e tarifës, me qëllim vendosjen e një çmimi preferencial për karikimin e taksive elektrike, si sektor publik me ndikim social dhe mjedisor; 3. Krijimin e një mekanizmi subvencioni ose lehtësie fiskale, për të shmangur kthimin e investimit ekologjik të qindra shoferëve në barrë ekonomike; si dhe parashtrime të tjera lidhur me rrezikun e falimentimit dhe ekspozimin financiar të operatorëve të taksive elektrike.

- Me shkresën e datës 24.10.2025, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” ka kërkuar ndër të tjera: mbajtjen e pandryshuar të çmimit të energjisë për pikat e karikimit të taksive; rishikimi i tarifave të taksimetrit; vendosja e skemave të kompensimit/rimbursimit specifik për taksitë elektrike; heqja e TVSH-së së shërbimit dhe të energjisë për taksitë elektrike; aplikimi i një tarife preferenciale energjie për pikat e karikimit të taksive; krijimi i një skeme rimbursimi për shmangien e rrezikut të falimentimit të kompanive dhe individëve që ofrojnë këtë shërbim publik.

- Me vendimin nr. 271, datë 31.10.2025, Bordi i ERE-s vendosi **të refuzojë kërkesat** e Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe Sindikatës Shqiptare

të Taksive për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw”.

- Neni 16 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neni 16 i rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, përcaktojnë se çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s rishikimin e një vendimi brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni, vetëm nëse paraqesin prova të reja që mund të çojnë në një vendimarrje të ndryshme ose nëse evidentohen gabime materiale. Kërkesa për rishikim nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveç rasteve kur Bordi vendos ndryshe.

- Në kuadër të kësaj procedure, vlerësohet se, në kuptim të nenit 3, pika 7, germa “b” dhe nenit 33, pikat 2 dhe 3 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikata Shqiptare e Taksive”, përfaqësojnë një kategori të përcaktueshme përdoruesish (taksitë elektrike të regjistruara për ushtrim aktiviteti), të cilët mund të preken drejtpërdrejt nga vendimi nr. 255/2025, ndaj legjitimohen si palë në procedurë. Kërkesat e tyre fillestare janë paraqitur brenda afatit 7-ditor ligjor, në përputhje me nenin 16, pika 1 të rregullores nr. 96/2016.

- Vendimi nr. 255, datë 15.10.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 15.10.2025. Për këtë arsye, në referim të kësaj date si moment i marrjes dijeni nga palët, shqyrtimi i praktikës administrative është kryer duke marrë në konsideratë vetëm kërkesat dhe dokumentet e paraqitura brenda afatit ligjor, siç është konstatuar në paragrafin e mësipërm.

- Ndryshe nga kërkesat fillestare, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë” ka depozituar edhe një shkresë shtesë, të protokolluar në ERE më datë 31.10.2025, në të cilën përsëriten shqetësimet lidhur me ndikimin ekonomik të çmimit të miratuar dhe kërkohet rishikimi i tij mbi bazën e kostove të operimit të taksive elektrike. Kjo shkresë është paraqitur jashtë afatit ligjor për depozitimin e provave të reja, nuk mund të merret në konsideratë për qëllime të rishikimit të vendimit. Për më tepër, edhe sikur të ishte paraqitur brenda afatit, përmbajtja e saj nuk përbën “provë të re” në kuptimin e nenit 16 të rregullores nr. 96/2016, pasi paraqet vetëm



argumente të karakterit ekonomik dhe shqetësime të operatorëve, pa sjellë elemente faktike ose dokumente të reja mbi bazën e të cilave të provohej se vendimi nr. 255/2025 është marrë mbi të dhëna të pasakta, se përmban gabime materiale apo se ekzistojnë rrethana të reja objektive që nuk kanë qenë të njohura në momentin e marrjes së vendimit.

- Nga shqyrtimi i praktikës administrative rezulton se vendimi nr. 255/2025 është marrë në zbatim të parimeve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, përfshirë parimin e mbulimit të kostove dhe të shmangies së ndërsuvencionimit ndërmjet kategorive të konsumatorëve. Çmimi i miratuar reflekton kostot e shërbimit dhe të disbalancave të shkaktuara në sistem nga pikat e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kw, me qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit elektroenergetik dhe të furnizimit universal. Kërkesat e Shoqatës dhe të Sindikatës nuk paraqesin argumente apo prova që të vërtetojnë se këto parime ligjore nuk janë respektuar, apo se vendimi nr. 255/2025 është marrë në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe metodologjinë në fuqi. Kërkesat e Shoqatës dhe Sindikatës nuk vënë në diskutim këto parime ligjore dhe nuk paraqesin argumente apo prova, që të vërtetojnë se vendimi nr. 255/2025 është në kundërshtim me ligjin sektorial ose me metodologjinë në fuqi.

- Në mbështetje të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 16 të Rregullores nr. 96/2016, rishikimi i një akti administrativ përbën një mjet të jashtëzakonshëm administrativ, i cili lejohet vetëm në prani të rrethanave ose provave të reja, me rëndësi vendimtare për çështjen, që nuk kanë qenë të njohura dhe nuk kanë mundur të njihen gjatë zhvillimit të procedurës që ka çuar në nxjerrjen e aktit.

- Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se parashtrimet e Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe të Sindikatës Shqiptare të Taksive nuk shoqërohen me prova të reja në kuptimin e nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 16 të rregullores nr. 96/2016, por paraqesin kryesisht një analizë të ndikimit ekonomik të vendimit mbi modelin e biznesit të operatorëve të taksive elektrike.

- Sipas nenit 146 të Kodit të Procedurave Administrative, organi që shqyrton kërkesën për rishikim duhet të vlerësojë nëse, në rrethanat

aktuale, akti administrativ do të ishte i paligjshëm, vetëm në këtë rast ky akt mund të anulohet, të ndryshohet ose të zëvendësohet. Në rastin konkret nuk rezulton që vendimi nr. 255/2025 të jetë i paligjshëm, as që të jetë marrë mbi bazën e të dhënave të pasakta ose të paplota.

- Për rrjedhojë, kërkesat për rishikim nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 144 dhe 146 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në nenin 16 të rregullores nr. 96/2016 për të justifikuar rishikimin e vendimit nr. 255/2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesave të Shoqatës “Taksitë e Klasit të Parë” dhe “Sindikatës Shqiptare të Taksive”, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025, me qëllim vendosjen e një çmimi preferencial, si të pambështetura në prova të reja, që mund të çonin Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 296, datë 17.11.2025

#### **MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 276, DATË 13.12.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘M.C ENERGJI GOJAN’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘GOJAN’”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, t ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave





Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2871 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘M.C Energji Gojan’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Gojan’”,

#### **Konstatoi se:**

#### **1. Të dhëna mbi shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k.:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 276, datë 13.12.2024, ka licencuar shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”.

- Në pikën 2 të vendimit nr. 276/2024 përcaktohet, se: “Shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda datës 28.11.2025”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet, se: “Ky vendim është objekt rishikimi”.

- Sipas raportimeve periodike të ERE-s, mbi të dhënat e tregut të energjisë elektrike, konstatohet se HEC “Gojan” ka hyrë në prodhim në muajin shkurt 2025.

#### **2. Analiza ligjore dhe vlerësimi:**

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duke përmbushur kushtin e vendosur. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e kushtit në pikën 2 të vendimit 276/2025, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit të lartpërmendur, e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

#### **3. Nevoja për ndryshimin e vendimit:**

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik, që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “M.C Energji Gojan” sh.p.k. ka përmbushur

kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### **VENDOSI:**

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “M.C Energji Gojan” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “Alpex” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrir Ahmeti

#### **VENDIM**

**Nr. 297, datë 17.11.2025**

#### **MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 123, DATË 4.4.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SUN ENERGY SOLUTIONS’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i



ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2872 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

### **1. Të dhëna mbi shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 123, datë 4.4.2023, ka licencuar shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikën 2 të vendimit 123/2023 përcaktohet se “Shoqëria duhet të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai deri më datë 6.9.2024”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi”.

### **2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria**

- Shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka depozituar pranë ERE-s raportimet periodike për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai për periudhën janar–shtator 2025. Nga shqyrtimi i këtyre raportimeve rezultoi se shoqëria ka hyrë në prodhim dhe po ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit.

### **3. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, duke përmblusur plotësisht kushtin e vendosur në vendim. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e këtij kushti, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit 123/2023, e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi, në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka përmblusur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 298, datë 17.11.2025

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN  
E BORDIT TË ERE-s NR. 176, DATË  
4.11.2020, “MBI LICENCIMIN E  
SHOQËRISË ‘KOKA & ERGI ENERGY  
STAVEC’ SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC ‘STAVEC’, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 6250 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave



Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2870 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Koka & Ergi Energy Stavec’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Stavec’, me kapacitet të instaluar 650 kw”,

konstatoi se:

### **1. Të dhëna mbi shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k.:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 176, datë 4.11.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec” me kapacitet të instaluar 6520 kw, për një afat 23-vjeçar.

- Në pikën 2 të vendimit të 176/2023 përcaktohet, se: “Shoqëria ‘Koka & Ergi Energy Stavec’ sh.p.k. të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të aplikimit për rinovim në çdo rast aplikimi, si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet, se: “Me plotësimin e afatit dhe kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi”.

### **2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria:**

- Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, i është referuar rinovimit të kontratës së qirasë, e cila është e vlefshme deri në vitin 2043, si dhe lejes së përdorimit të burimit uJOR me afat vlefshmërie deri më 10.8.2025.

- Për sa i përket rinovimit të kontratës së qirasë, në vijim të ndryshimeve të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke

shfuqizuar gërmën “g”, të pikës 2, të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti.

- Në lidhje me rinovimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR, e cila ka pasur afat vlefshmërie deri më 10.8.2025, shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765 prot., datë 15.8.2024, ka paraqitur një kërkesë lidhur me modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike. Ndër dokumentacionin e paraqitur bashkëlidhur këtij aplikimi, ndodhet edhe leja për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor me nr. 27 prot., datë 7.11.2022, e miratuar me vendim të Këshillit të Basenit UJOR Mat, nr. 26, datë 12.10.2022, e cila e ka periudhën e vlefshmërisë sipas kontratës së koncesionit. Subjekti ka rinovuar lejen e përdorimit të burimit uJOR brenda afatit të vlefshmërisë dhe kjo leje është e vlefshme përgjatë gjithë periudhës së licencimit.

### **3. Analiza ligjore dhe vlerësimi:**

- Shoqëria është realizuar për të gjithë periudhën e licencimit si në rastin e lejes së përdorimit të burimit uJOR, si në rastin e kontratës së qirasë që nuk është më kërkesë e rregullores për licencim, kështu vlerësohet se kushti është i përmbushur nga shoqëria dhe për rrjedhojë duhet shfuqizuar.

- Me shfuqizimin e këtij kushti, atëherë duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit 176/2020, e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet që pikat 2 dhe 3 të vendimit të Bordit të ERE nr. 176, datë 4.11.2020, duhet të shfuqizohen pasi “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, shfuqizohen.



2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 299, datë 17.11.2025**

**MBI MIRATIMIN E “STRATEGJISË SË  
ERE-s PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI  
KURSIN E ENERGJISË DHE  
PËRDORIMIN E BURIMEVE  
ALTERNATIVE, 2025–2030”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 9, të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024”, miratuar më datë 9.10.2025; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe Sekretarit të Përgjithshëm, me nr. 2866 prot., datë 4.11.2025, “Mbi miratimin e ‘Strategjisë së ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative, 2025–2030’”,

konstatoi se:

- Pika 9, e Rezolutës së Kuvendit, e cila rekomandon ERE-n, që pas nënshkrimit të

marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë (AEE), të hartojë një strategji të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë.

- Në përputhje me objektivat dhe pritshmëritë e përcaktuara në Rezolutë, ERE ka detyrimin të forcojë rolin e saj në: nxitjen e masave për rritjen e ndërgjegjësimin të konsumatorëve për kursimin e energjisë; bashkëpunimin ndërinstitucional me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë; promovimin e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe teknologjive të pastra; informimin publik mbi politikat e tarifimit dhe shërbimet ndaj konsumatorëve.

- Strategjia 2025–2030 është hartuar si një dokument bashkëpunimi ndërinstitucional midis ERE dhe Agjencisë së Eficiencës së Energjisë (AEE), me qëllim:

- rritjen e ndërgjegjësimin të konsumatorëve për kursimin e energjisë dhe përdorimin racional të saj;

- promovimin e burimeve alternative dhe të teknologjive të rinovueshme si energjia diellore dhe e erës;

- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të siguruar një koordinim efektiv të politikave publike mbi eficiencën energjetike;

- krijimin e një vitrine digjitale të përbashkët, që do të shërbejë si qendër informacioni, edukimi dhe monitorimi mbi përdorimin e energjisë në familje, biznese dhe institucione publike;

- matjen dhe raportimin periodik të progresit përmes indikatorëve të qartë dhe analizave të matshme të rezultateve.

- Kjo strategji përbën një instrument të rëndësishëm për forcimin e rolit të ERE-s në mbrojtjen e konsumatorit, edukimin dhe ndërgjegjësimin energjetik të publikut, promovimin e burimeve alternative, si dhe ndërtimin e një sistemi energjetik më të qëndrueshëm dhe të drejtë për të gjithë përdoruesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Strategjisë së ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative 2025–2030” (bashkëlidhur).



2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshme për përgatitjen e një plan veprimi për zbatimin e strategjisë brenda datës 15 dhjetor 2025.

3. Ngarkohen Drejtoritë Teknike për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative, për periudhën 2025–2030.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

## STRATEGJIA E ERE-s PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI KURSIN E ENERGJISË DHE PËRDORIMIN E BURIMEVE ALTERNATIVE

**Afati kohor: 2025–2030**

**Institucionet:** Enti Rregullator i Energjisë  
(ERE) dhe Agjencia e Eficiencës së Energjisë  
(AEE)

### 1. Hyrje

Energjia është një nga faktorët kryesorë jo vetëm për zhvillimin ekonomik të një vendi, por edhe për cilësinë e jetës së qytetarëve. Disponueshmëria e energjisë, kostoja e saj dhe mënyra se si menaxhohet, ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik, funksionimin e bizneseve dhe shërbimet publike, si dhe në shëndetin dhe mirëqenien e familjeve. Në kontekstin shqiptar, sektori energjetik po përjeton një transformim të thellë dhe progresiv, duke përfshirë integrimin e burimeve të rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo e erës, dhe adoptimin e teknologjive të avancuara për menaxhimin dhe shpërndarjen më efikase të energjisë.

Megjithatë, përtej përmirësimeve teknologjike, një nga sfidat kryesore mbetet rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për kursimin dhe përdorimin racional të energjisë. Ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve dhe promovimi i përdorimit të burimeve alternative, janë elemente kyçe për arritjen e eficiencës energjetike në të gjitha nivelet: familjar, biznese dhe institucione publike. Për këtë arsye, edukimi i konsumatorit dhe ofrimi i mjeteve për menaxhimin e energjisë janë po aq të rëndësishme sa investimet infrastrukturore.

Ky dokument synon të paraqesë një strategji afatmesme bashkëpunimi mes Entit Rregullator të

Energjisë (ERE) dhe Agjencisë për Eficiencën e Energjisë (AEE). Strategjia përfshin objektiva të qarta, modalitete konkrete të implementimit dhe rolin e ERE-s në arritjen e tyre. Përveç kësaj, ajo fokusohet tek bashkëpunimi ndërinstitucional, duke krijuar ura komunikimi dhe koordinimi midis aktorëve të ndryshëm të sektorit energjetik, dhe tek mbrojtja e interesave të konsumatorit. Qëllimi është të sigurohet një qasje e integruar, që kombinon politikat rregullatore, promovimin e burimeve të rinovueshme, dhe masat për eficiencë energjetike, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

### 2. Sfondi dhe motivimi

Shqipëria po përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme në sektorin energjetik, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e furnizimit, zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve:

- Rritja e konsumit të energjisë elektrike dhe trysnia mbi rrjetin e shpërndarjes: Konsumi i energjisë po rritet vazhdimisht, si pasojë e zhvillimit ekonomik, urbanizimit dhe rritjes së përdorimit të pajisjeve elektrike në familje dhe biznese. Kjo krijon presion mbi rrjetin ekzistues të shpërndarjes, duke bërë më të vështirë menaxhimin e ngarkesave dhe garantimin e furnizimit të pandërprerë;

- Nevoja për integrim të energjisë diellore, erës dhe burimeve të tjera alternative: Për të reduktuar varësinë nga burimet konvencionale dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemit, është e domosdoshme përdorimi i energjisë së rinovueshme. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve të energjisë diellore, erës, si dhe teknologjive të tjera inovative që mund të kontribuojnë në diversifikimin e burimeve energjetike;

- Nivel i ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi kursimin dhe menaxhimin eficient të energjisë: Një sfidë e madhe mbetet sjellja e konsumatorëve, të cilët shpesh nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi mënyrat e kursimit të energjisë, përdorimin racional të pajisjeve dhe mundësitë për të reduktuar shpenzimet. Ndërgjegjësimi i ulët çon jo vetëm në humbje financiare për familjet dhe bizneset, por edhe në ngarkesë shtesë mbi rrjetin energjetik;

- Sfida lidhur me faturimin, pikat e konsumit me humbje energjie dhe mungesën e informacionit mbi opsionet alternative: Problemet në sistemin e faturimit, si dhe humbjet e energjisë në pikat e konsumit, ndikojnë negativisht në efikasitetin e sektorit. Po ashtu, mungesa e informacionit mbi



opsionet alternative dhe teknologjitë që mund të ndihmojnë në uljen e konsumit energjetik kufizon mundësitë e qytetarëve për të adoptuar zgjidhje më të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, roli i institucioneve rregullatore dhe promovuese është kyç:

- Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka përgjegjësi kryesore për mbikëqyrjen e tregut të energjisë, rregullimin e tarifave dhe mbrojtjen e konsumatorit. ERE siguron që proceset e faturimit, shpërndarjes dhe tarifimit të jenë transparente dhe të drejtë për të gjithë aktorët e tregut;

- Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) ka përgjegjësi për promovimin e eficiencës energjetike, zhvillimin e materialeve edukative, kryerjen e analizave teknike dhe hartimin e udhëzimeve për përdorimin e burimeve alternative. AEE-ja ndihmon qytetarët dhe bizneset të kuptojnë mënyrat më efektive për të kursyer energji dhe për të adoptuar teknologji të gjelbërta;

Bashkëpunimi midis ERE-s dhe AEE-së është thelbësor për të arritur efekt maksimal në ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe përdorimin racional të energjisë. Vetëm përmes koordinimit të politikave rregullatore, promovimit të edukimit dhe ofrimit të informacionit teknik të qartë mund të arrihet një sistem energjetik më i qëndrueshëm, efikas dhe i orientuar drejt qytetarëve.

### 3. Qëllimi i strategjisë

Qëllimi kryesor i strategjisë është ndërtimi i një platforme (këtu e në vijim Platforma) mes Entit Rregullator të Energjisë (ERE), e cila synon të përmirësojë menaxhimin e energjisë dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve për përdorimin racional dhe eficient të saj. Platforma ka potencialin të veprojë si një mjet për koordinimin e politikave, promovimin e inovacionit dhe monitorimin e performancës së masave të implementuara. Në këtë kontekst, objektivat kryesore të platformës janë:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi kursimin dhe eficiencën e energjisë:

Konsumatorët luajnë një rol kyç në eficiencën e sistemit energjetik. Platforma do të ofrojë informacione të qarta dhe të strukturuar mbi mënyrat për të kursyer energji në shtëpi, në biznes dhe në institucionet publike. Kjo përfshin këshilla praktike, udhëzime për përdorimin optimal të pajisjeve elektrike, promovimin e instrumenteve të matjes dhe monitorimit të konsumit, si dhe nxitjen e

sjelljeve të qëndrueshme që reduktojnë shpenzimet dhe ndikimin mjedisor.

2. Promovimi i përdorimit të burimeve alternative të energjisë:

Platforma do të ketë një rol aktiv në edukimin e qytetarëve dhe bizneseve mbi përfitimet e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë energjinë diellore, energjinë e erës dhe teknologjitë e tjera inovative. Përmes materialeve informuese, udhëzimeve teknike dhe shembujve praktikë, do të nxitë përdorimin e burimeve alternative, reduktimin e varësisë nga burimet konvencionale dhe rritjen e qëndrueshmërisë energjetike.

3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional:

Një nga elementet kryesore për suksesin e strategjisë është koordinimi mes ERE-s dhe AEE-së, por edhe midis institucioneve të tjera shtetërore, operatorëve të rrjetit dhe aktorëve privatë. Platforma do të funksionojë si një vitrinë informacioni, duke lehtësuar shpërndarjen, shkëmbimin e informacionit, harmonizimin e politikave dhe implementimin e masave që bashkojnë objektivat e ERE-s me ato të AEE-së. Ky bashkëpunim do të sigurojë që iniciativat të jenë të qëndrueshme, të koordinuara dhe të fokusuara drejt rezultateve konkrete.

4. Krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit:

Për të matur efektivitetin e strategjisë, platforma do të përfshijë mekanizma të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Kjo përfshin matjen e nivelit të ndërgjegjësimit të konsumatorëve, përdorimin e energjisë dhe adoptimin e teknologjive alternative, rritjen e numrit të njërive të banimit që kanë aplikuar normat më të mira teknike ndërtuese për rritjen e eficiencës së energjisë, etj. Të dhënat e mbledhura do të analizohen për të identifikuar sukseset, dobësitë dhe zonat që kërkojnë përmirësim. Kjo qasje e bazuar në të dhëna do të sigurojë vendimmarrje të informuar dhe përshtatje të vazhdueshme të strategjisë për rezultate më të larta.

### 4. Objektivat e strategjisë

#### 4.1 Objektiva kryesore

Objektivat e platformës së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë të dizajnuara për të përmirësuar menaxhimin e energjisë, për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve energjetike. Këto objektiva kryesore përfshijnë:



1. Edukimi dhe informimi i konsumatorëve për praktikën e kursimit të energjisë dhe përdorimin eficient të pajisjeve elektrike:

Një nga prioritetet kryesore është ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve. Platforma do të ofrojë materiale edukative, udhëzime praktike dhe këshilla për përdorimin optimal të pajisjeve elektrike në shtëpi, biznese dhe institucione. Kjo përfshin teknika për uljen e konsumit në kohë piku të lartë, përdorimin e pajisjeve me efikasitet energjetik të certifikuar dhe adoptimin e praktikave të menaxhimit të energjisë që reduktojnë shpenzimet dhe ndikimin mjedisor.

2. Zhvillimi i standardeve për përdorimin racional të energjisë në biznes dhe institucione:

Për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të energjisë në sektorin publik dhe privat, do të ketë udhëzime që orientojnë institucionet dhe bizneset drejt praktikave më efikase. Këto standarde do të përfshijnë kriteret për matjen dhe raportimin e konsumit energjetik, përdorimin e pajisjeve me eficiencë të lartë dhe integrimin e masave për uljen e humbjeve të energjisë.

3. Promovimi i burimeve alternative të energjisë:

Platforma do të nxisë adoptimin e teknologjive të rinovueshme, përfshirë panelet diellore, dhe sistemet e magazinimit të energjisë. Informacioni do të përqendrohet në përfitimet ekonomike dhe mjedisore të këtyre burimeve, mundësitë e financimit dhe stimulimet e mundshme, si dhe shembuj praktikë të implementimit të tyre në shtëpi, biznese dhe institucione publike.

4. Integrimi i praktikave të eficiencës energjetike në rrjetin e shpërndarjes dhe në politikat e tarifimit:

Përveç edukimit të konsumatorëve, platforma do të mbështesë hartimin e politikave dhe praktikave që përmirësojnë eficiencën e rrjetit energjetik. Kjo përfshin optimizimin e shpërndarjes së energjisë, reduktimin e humbjeve në rrjet dhe përshtatjen e tarifave për të stimuluar përdorimin racional të energjisë nga konsumatorët. Integrimi i këtyre masave do të ndihmojë në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe më të efektshëm.

5. Sigurimi i informacionit të qartë, transparent dhe të besueshëm për konsumatorët:

Një element kyç i strategjisë është ofrimi i informacionit të plotë dhe të lehtë për t'u kuptuar për qytetarët dhe bizneset. Kjo përfshin të dhëna mbi masat e kursimit, teknologjitë alternative, mundësitë financiare dhe stimujt që ofrohen nga

institucionet publike. Transparenca dhe besueshmëria e informacionit do të rrisin besimin e konsumatorëve dhe do të inkurajojnë adoptimin e praktikave më të mira për eficiencën energjetike.

#### 4.2 Objektiva të veçantë

- Të rritet pjesëmarrja e konsumatorëve në fushata ndërgjegjëse;

- Të stimulohet përdorimi i instrumenteve digjitale (logaritës energjie, simulime, aplikacione mobile);

- Të zhvillohen materiale edukative të bazuara në evidenca dhe të aksesueshme për të gjithë;

- Të forcohet monitorimi i ndikimit të masave dhe raportimi periodik i rezultateve.

#### 5. Interesat e konsumatorit

Konsumatori i energjisë ka një interes të drejtpërdrejtë dhe shumëdimensional në përdorimin eficient dhe të qëndrueshëm të energjisë. Këto interesa lidhen jo vetëm me kostot financiare, por edhe me sigurinë, stabilitetin dhe ndikimin mjedisor të konsumit energjetik. Nga një perspektivë teknike, interesat kryesore të konsumatorit përfshijnë:

1. Reduktimi i kostove të faturave për energji elektrike, ngrohje dhe ftohje:

Efikasiteti energjetik i pajisjeve dhe menaxhimi optimal i konsumit kanë ndikim direkt në shpenzimet e përditshme të familjeve dhe bizneseve. Konsumatori kërkon zgjidhje që reduktojnë humbjet e energjisë në rrjet dhe përdorimin e panevojshëm të energjisë, duke përfshirë teknologji si termostatat inteligjente, matësit e konsumit në kohë reale dhe pajisjet me etiketë energjetik.

2. Siguria dhe stabiliteti i furnizimit me energji:

Konsumatori ka interes që furnizimi me energji të jetë i pandërprerë dhe i besueshëm, duke minimizuar ndërprerjet që mund të shkaktojnë humbje ekonomike dhe shqetësime sociale. Nga një këndvështrim teknik, kjo lidhet me monitorimin e ngarkesave në rrjet, menaxhimin e burimeve të furnizimit dhe implementimin e masave për reduktimin e humbjeve në linjat e shpërndarjes.

3. Zgjidhjet miqësore me mjedisin:

Konsumatori sot është gjithnjë e më shumë i ndërgjegjshëm për ndikimin mjedisor të përdorimit të energjisë. Përdorimi i burimeve alternative si energjia diellore, energjia e erës dhe biomasë, si dhe adoptimi i pajisjeve energjetike me efikasitet të lartë, ul emetimet e karbonit dhe përdorimin e burimeve fosile. Kjo jo vetëm që kontribuon në ruajtjen e



mjedisit, por edhe ndikon në përfitime ekonomike afatgjata përmes uljes së kostove të energjisë dhe stimulimeve të mundshme nga institucionet.

#### 4. Qasje në teknologji moderne dhe efikase:

Konsumatori ka interes të ketë mundësi të përdorë pajisje dhe sisteme inteligjente që lehtësojnë menaxhimin e energjisë. Kjo përfshin panele diellore, sisteme të magazinimit të energjisë, matës inteligjent të energjisë, pajisje të lidhura në rrjet (*smart grid*) dhe teknologji për monitorim dhe kontroll në kohë reale. Këto sisteme ofrojnë jo vetëm efikasitet më të lartë, por edhe transparencë mbi përdorimin e energjisë dhe mundësi për optimizim të shpenzimeve.

#### 5. Informim dhe mbrojtje ligjore:

Konsumatori ka interes që informacioni mbi konsumimin dhe alternativat energjetike të jetë i qartë, transparent dhe i besueshëm. Kjo përfshin raportime të sakta mbi faturat, udhëzime mbi kursimin, fushata ndërgjegjësimi dhe qasje në mekanizma mbrojtjeje ligjore. Një konsumator i informuar mund të marrë vendime të arsyeshme dhe të përfitojë nga stimujt, subvencionet dhe teknologjitë e reja për eficiencë energjetike.

#### 6. Modalitetet e arritjes së objektivave

Qëllimi kryesor i këtij plani strategjik është rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve dhe bizneseve për eficiencën energjetike, përdorimin racional të energjisë dhe adoptimin e burimeve alternative, duke kombinuar fushata publike, trajnime, teknologji digjitale dhe monitorim të avancuar të rezultateve.

##### 1. Fushata ndërgjegjëse publike

Fushatat ndërgjegjëse synojnë të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të ndryshme, duke përdorur kanale të ndryshme dhe materiale të përshtatura për çdo targetgrup:

- Materiale edukative: Broshura, manuale, video dhe infografikë që ofrojnë udhëzime praktike mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e pajisjeve me eficiencë të lartë. Infografikët do të fokusohen në statistika dhe tregues të qartë për konsumimin energjetik, kostot dhe përfitimet e adoptimit të burimeve alternative.

- Media digjitale: Do të përdoren platformat digjitale, rrjetet sociale dhe faqja zyrtare e ERE-s, në një zë të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, për të arritur një audiencë më të re dhe teknologjikisht të avancuar. Strategjia digjitale përfshin video të shkurtra, postime interaktive dhe artikuj edukativë të

përqendruar tek praktikat e kursimit dhe teknologjitë alternative.

- Evente publike: *Workshop*-e dhe ditë të hapura për qytetarët dhe bizneset ku prezantohen zgjidhjet praktike për eficiencën energjetike dhe ekspozime të teknologjive të rinovueshme. Këto aktivitete synojnë të krijojnë përvojë të drejtpërdrejtë për përdoruesit dhe të stimulojnë adoptimin e praktikave të reja.

##### 2. Trajnime dhe seminare për biznes dhe institucione publike

Trajnimet janë të dizajnuara për të ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi praktike për implementimin e masave të eficiencës energjetike:

- Demonstrim i përdorimit të burimeve alternative: Prezantimi i potencialit të paneleve diellore, turbina të vogla të erës dhe magazinimit të energjisë, si dhe analiza e kostos dhe përfitimeve të integritetit të tyre në biznes dhe institucione publike;

- Udhëzime për monitorim dhe raportim të konsumit: Ofrimi i metodologjive standarde për matjen, raportimin dhe analizën e konsumit energjetik, duke përdorur softuerë monitorimi dhe matës inteligjentë që lehtësojnë vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

##### 3. Platforma *online* dhe aplikacione

Teknologjia digjitale do të luajë një rol kyç në ndërgjegjësim dhe asistencë të konsumatorit:

- Simulime të kursimit energjie: *Tools* interaktive që lejojnë qytetarët dhe bizneset të simulojnë kursimet që mund të realizojnë, duke ndryshuar sjelljet ose duke adoptuar pajisje më efikase;

- Llogaritës për përfitimet nga përdorimi i burimeve alternative: Kalkulatorë që japin parashikime të kosto/përfitimit, kohë amortizimi dhe ndikim mjedisor për sistemet diellore, apo ato eolike;

- Forum dhe qasje në udhëzime teknike: Një hapësirë interaktive ku përdoruesit mund të ndajnë përvojat, të bëjnë pyetje dhe të marrin udhëzime teknike të detajuara nga ekspertët e ERE-s dhe AEE-së.

##### 4. Monitorimi dhe raportimi i efektivitetit

Për të garantuar rezultate të matshme dhe përmirësim të vazhdueshëm, platforma përfshin mekanizma të avancuar monitorimi dhe analizimi të performancës:

- Raporte gjashtëmujore: Përfshijnë analizën e aktivitetit të ndërgjegjësimin, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bizneseve në evente, përdorimin e



materialeve edukative dhe ndryshimet në praktikat e kursimit të energjisë;

- Raporte vjetore: Fokusohen në ndikimin në treg, adoptimin e teknologjive alternative dhe sjelljet e operatorëve të rrjetit dhe konsumatorëve, duke vlerësuar efektet mbi konsumin dhe kostot totale të energjisë;

- Analizë e treguesve kryesorë: Përdorimi i indikatorëve të matshëm si pjesëmarrja në aktivitetet edukative, niveli i adoptimit të pajisjeve dhe teknologjive alternative, reduktimi i konsumit energjetik dhe kursimet financiare, si dhe ndikimi mjedisor i masave të implementuara. Këto analiza do të shërbejnë si bazë për përshtatjen dhe optimizimin e strategjisë në kohë reale.

#### 5. Bashkëpunimi ndërinstitucional

- ERE do të krijojë një grup pune koordinimi me pjesëmarrje nga të gjitha strukturat e ERE-s që për kompetencë adresojnë çështje që lidhen me implementimin e fushatave.

- Bashkëpunimi do të përfshijë ndarjen me Agjencinë e Eficiencës të të dhënave të publikuara rast pas rasti në platformë, me qëllim rishpërndarjen e tyre apo publikimin e koordinuar të materialeve informative, si dhe organizimit apo ndjekjes së përbashkët të aktiviteteve të planifikuara në strategji, për aq sa është e mundur.

#### 6. Monitorimi dhe vlerësimi i progresit

- Treguesit kryesorë të suksesit;
- Numri i konsumatorëve të trajnuar ose të informuar;
- Përdorimi i teknologjive alternative;
- Reduktimi i kostove dhe konsumin energjetik;
- Pjesëmarrja në platforma dhe aktivitete digjitale.

- Raportimi dhe analiza;
- Raporte gjashtëmujore mbi aktivitetet edukative;

- Raporte vjetore nga ERE mbi ndikimin në treg dhe operatorët;

- Analiza periodike për rishikimin e strategjisë dhe përshtatjen e masave.

#### 7. Afati kohor dhe fazat e implementimit

- Faza 1 – Planifikimi, hartimi, miratimi: 2025.
- Faza 2 – Implementimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere: 2025–2027.

- Faza 3 – Monitorim dhe vlerësim i efektivitetit: 2026–2029.

- Faza 4 – Përmirësim dhe konsolidim i strategjisë: 2028–2030.

#### 8. Përfundim

Strategjia e ERE-s përbën një hap të rëndësishëm dhe themelor në përpjekjet për të modernizuar sektorin energjetik shqiptar, duke vendosur konsumatorin në qendër të procesit të menaxhimit dhe përdorimit të energjisë. Ky dokument nuk është thjesht një udhëzues politikash, por një plan i detajuar dhe i integruar që lidh ndërgjegjësimin e qytetarëve, promovimin e eficiencës energjetike dhe adoptimin e burimeve alternative me koordinimin e ngushtë ndërinstitucional.

Në thelb, strategjia synon të krijojë një platformë të qëndrueshme që mundëson edukimin e konsumatorit në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive. Përmes fushatave publike, trajnimeve, seminareve dhe përdorimit të teknologjive digjitale, konsumatorët do të marrin njohuritë dhe mjetet praktike për të menaxhuar konsumimin e energjisë, për të reduktuar humbjet dhe kostot, dhe për të adoptuar zgjidhje të qëndrueshme energjetike.

Implementimi i strategjisë, gjithashtu, mundëson integrimin e teknologjive moderne në sistemin energjetik, duke përfshirë pajisje inteligjente, sisteme monitorimi në kohë reale, dhe burime alternative si: energjia diellore, energjia e erës dhe biomasa. Këto masa do të rrisin efikasitetin e rrjetit, do të reduktojnë ngarkesën dhe humbjet, dhe do të kontribuojnë në një përdorim më racional dhe të optimizuar të energjisë në të gjitha nivelet – familje, biznese dhe institucione publike.

Në përfundim, strategjia nuk është vetëm një plan veprimi, por një vizion i gjerë për një sistem energjetik më të qëndrueshëm, më të sigurt dhe më efikas. Ajo krijon mundësi për qytetarët dhe bizneset që të përfitojnë nga teknologjitë e avancuara, të reduktojnë kostot dhe ndikimin mjedisor, dhe të kontribuojnë në një ekonomi më të gjelbër dhe konkurruese. Zbatimi i saj do të vendosë një standard të ri për menaxhimin e energjisë në Shqipëri, duke siguruar që konsumatori të jetë jo vetëm përdorues, por edhe aktor aktiv dhe i informuar në rrjetin energjetik, dhe duke krijuar një themel të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm energjetik në të ardhmen.

**VENDIM****Nr. 300, datë 17.11.2025**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
DISA NDRYSHIME NË  
“RREGULLOREN PËR CILËSINË E  
FURNIZIMIT DHE PERFORMANCËN E  
SIGURISË SË RRJETIT NË SISTEMIN E  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.  
207, DATË 18.12.2017 DHE NË  
TREGUESIT E KRITEREVE  
STANDARDE TË CILËSISË SË  
SHËRBIMIT NË SISTEMIN E  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 7, pikat 1; 16 dhe 19, gerrat “h” dhe “j”; 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të neneve 19, germa “f” dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, me nr. 2865 prot., datë 14.11.2025, “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në ‘Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike’, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”. Kjo rregullore specifikon treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën, në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e Treguesve të Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2021 ku: koha

mesatare e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike (AIT) – 35 minuta, energjia e pa furnizuar (ENS) – 467 mwh, indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI) – 104 minuta.

- Me vendimin nr. 244, datë 2.12.2021, “Mbi propozimin e ‘OST’ sh.a., për treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022”, Bordi i ERE-s, rishikoi treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike duke përcaktuar: koha mesatare e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike (AIT) – 35 minuta, energjia e pa furnizuar (ENS) – 467 mwh, indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve (SAIDI) – 100 minuta.

- Kuvendi i Shqipërisë, në “Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024”, miratuar në datën 9.10.2025, rekomandon, ndër të tjera, për marrjen e masave për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët e energjisë elektrike.

- Në zbatim të urdhrit të kryetarit të ERE-s, u ngrit grupi i punës me qëllim rishikimin e treguesve të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

- Rezulton se, shoqëria “OST” sh.a. ka përcjellë periodikisht raportimet mbi Standardet e arritura të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Nga parametrat e paraqitura nga “OST” sh.a., shihet qartazi një ndryshim në disa nga treguesit, duke rezultuar në përmirësim, konkretisht gjatë viteve 2023 dhe 2024.

- ERE ka kryer monitorim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të treguesve mbi standardet e arritura të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën prill/maj/qershor 2024. Nga ky monitorim rezultoi se treguesit e cilësisë së shërbimit në rrjetin e transmetimit janë përllogaritur konform rregullores së miratuar nga Bordi i ERE-s dhe respekton dispozitat përkatëse të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rregullat dhe procedurat kombëtare të sigurisë dhe garantimit pa ndërprerje të furnizimit me energji elektrike, detyrimin e shërbimit publik, rregullat dhe standardet teknike Kodit të Rrjetit të



Transmetimit Kombëtar, të Rrjetit të Transmetimit Evropian ENTSO-E.

- Edhe gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2025, ka rezultuar një zhvillim pozitiv sidomos për treguesit SAIDI-n (indeksin e kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve), i cili për tremujorin e dytë të vitit 2025 ka shënuar një rënie të konsiderueshme në 6.78 minuta, nga 18.19 minuta në të njëjtën periudhë të 3-mujorit të dytë të vitit 2024.

- Rezulton se, AIT (koha mesatare e ndërprerjes) ka ulje të kohës mesatare të ndërprerjes nga 28.87 min. në 25.96 min., ENS (energji e pa furnizuar) ka një trend rënieje nga 383,687 mwh në 365,997 mwh, SAIDI (indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve) ka një reduktim të kohës së ndërprerjeve dhe përmirësim të cilësisë së rrjetit nga 42.21 min. në 39.48 min.

- Gjithashtu, Bordi i ERE-s, me vendimin e nr. 63, datë 11.4.2022, ka miratuar kodin e transmetimit, në të cilën përcakton në aneksin I të saj (tabela nr. 1 dhe 2) se: “diapazonet e tensionit në pikën e lidhjes 110 kV – 300 kV është brenda 0,09 pu – 1,118 pu; si dhe diapazonet e tensionit në pikën e lidhjes 300 kV – 400 kV është brenda 0,90 pu – 1,05 pu.”.

- Kodi i Transmetimit afekton ndryshimet edhe në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”. Vlerësojmë se parametri i VQ (Cilësia e Tensionit), duhet të përshtatet sipas aneksit I, të Kodit të Transmetimit, si më sipër cituar.

- Po ashtu në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka disa dispozita të cilat për shkak të implementimit të tyre ndër vite, apo humbjes së aktualitetit, vlerësohet se duhet të shfuqizohen apo rishikohen.

- Neni 12 i “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, parashikon se: “Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në aneksin e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e

transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, miratuar me vendimin nr. 244, datë 2.12.2021, sipas tabelës së standardeve të cilësisë:

- AIT (koha mesatare e ndërprerjes) është 35 min. – propozohet të bëhet 25.96 min.;

- ENS (energji e pafurnizuar) është 467 mwh – propozohet të bëhet 365.997 mwh; si dhe

- SAIDI (indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve) është 100 min. – propozohet të bëhet 39.48 min.;

- VQ (cilësia e tensionit) është brenda diapazonit: -10%, +11.8 – propozohet të bëhet brenda diapazonit (110 kV – 300 kV): 0.90 pu – 1.118; dhe brenda diapazonit (300 kV – 400 kV): 0,90 pu – 1,05 pu;

- Neni 6 i “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të shfuqizohet;

- Paragrafi i fundit i pika 7.1, e nenit 7, të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të bëhet: “Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar”;

- Pika 7.2, e nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të shfuqizohet;

- Pika 7.3, e nenit 7 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të bëhet: “OST” sh.a. ose ERE me iniciativën e saj do të propozojë dhe ERE do të miratojë nivelin e lejuar të rishikuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur, raportuar dhe ushtruar;

- Pika 7.4, e nenit 7, të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”,



miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të bëhet: “Jo më vonë se njëherë në 3 vjet ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit”;

- Pika 9.1 e nenit 9 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, propozohet të bëhet: “Kompensimi i klientëve fundor, të lidhur në rrjetin e transmetimit, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe marrëveshjes së shërbimit të transmetimit”.

2. Drejtoria Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë “OST” sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 301, datë 17.11.2025**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“NIKOLICA SKI RESORT” SHPK NË**  
**VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të

ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2427/13 prot., datë 13.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nikolica Ski Resort’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nikolica Ski Resort” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2427 prot., datë 9.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 214, datë 18.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.9.2025 dhe 20.9.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2427/3 prot., datë 25.9.2025, si dhe i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- ERE, po ashtu, me shkresën nr. 2427/5 prot., datë 25.9.2025, ka njoftuar edhe Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) për fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k.. Në vijim, AAC, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2427/7 prot., datë 22.10.2025, ka kërkuar informacion mbi pozicionimin e saktë të projektit dhe turbinave eolike, si dhe lartësitë përkatëse të tyre. Në përgjigje, ERE, me shkresën 2427/8 prot.,



datë 31.10.2025, në të cilën ka vënë për dijeni dhe shoqërinë, ka sqaruar se njoftimi bëhet në kuadër të informimit, ndaj në rast të nevojës për informacion shtesë, duhet t'i drejtohen subjektit përkatës.

- Me shkresën nr. 2427/4 prot., datë 25.9.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluara në ERE me nr. 2427/6 prot., datë 14.10.2025, ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues për aplikimin, nga analizimi i të cilit u konstatua se kishte ende nevojë për sqarime të mëtejshme, ndaj u vlerësua të zhvillohet një seancë dëgjimore, e cila iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 2427/9 prot., datë 31.10.2025, Kjo shkresë i është dërguar shoqërisë edhe në format elektronik nëpërmjet *email*-it të së njëjtës ditë.

- Në vijim, duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk u paraqit asnjë përfaqësues dhe nuk u përcoll asnjë argumentim, në lidhje me mosparaqitjen në seancën dëgjimore të datës 5.11.2025, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in nr. 2427/11 prot., datë 7.11.2025, duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit të specifikuar dhe në shkresën e datës 31.10.2025.

- Së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2427/12 prot., datë 11.11.2025, shoqëria ka informuar se shkresën njoftuese të ERE-s e ka marrë pas datës së planifikuar të seancës dhe ka depozituar informacion plotësues të aplikimit.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria është pajisur me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 215, datë 13.4.2023, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria ‘Nikolica Ski Resort’ sh.p.k.”.

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën e datës 14.2.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike eolik, me kapacitet prodhues 3 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria ‘Nikolica Ski Resort’ sh.p.k.”.

- Me shkresën e “OST” sh.a. nr. 2290/1 prot., datë 6.6.2022, ka marrë miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprahe, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më datë 22.8.2025, për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 3 mw, dhe veprave ndihmëse në zonën e Tragjasit, Vlorë”.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka deklaruar se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 49 vjet, si dhe ka depozituar një analizë teknike nga ku rezulton se jetëgjatësia e centralit është 49 vjet, por duke qenë se afati maksimal sipas të cilit lëshohet licenca është 30 vite, atëherë, shoqëria do të licencohet për një afat 30-vjeçar.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit, rezulton se shoqëria nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar/marrëveshjen përkatëse për pikën e lidhjes së centralit eolik, por duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit eolik, lidhja e tij me rrjetin elektrik është e garantuar, vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me “OST” sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 22.8.2027, dhe duke marrë në konsideratë faktin se vetë shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda datës 13.4.2026, afat i cili përkon dhe me afatin e përcaktuar në kontratën me MIE-n, ndaj vlerësohet që t'i lihet detyrë shoqërisë për të filluar ushtrimin e



veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda këtij afati. Po ashtu, duke marrë në konsideratë afatin e shkurtër brenda të cilit shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, vlerësohet që, në kuadër të raportimeve periodike që shoqëria depoziton në ERE, ajo duhet të paraqesë dhe raportimet periodike drejtuar MIE-s, në kuadër të ecurisë së ndërtimit dhe vënies në punë të centralit.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës me MIE-n, vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, për një afat 30-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit.

3. Shoqëria “Nikolica Ski Resort” sh.p.k. duhet të fillojë operimin e centralit eolik brenda datës 13.4.2026.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Nikolica Ski Resort” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 302, datë 17.11.2025

#### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPITALLA SOLAR” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2403/12 prot., datë 13.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Spitalla Solar’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Spitalla Solar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2403 prot., datë



4.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 215, datë 18.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.9.2025 dhe 20.9.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2403/6 prot., datë 25.9.2025, si dhe i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2403/7 prot., datë 25.9.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluara në ERE me nr. 2403/8 prot., datë 14.10.2025, shoqëria ka depozituar një argumentim teknik, në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit, ku sqaron se fuqia e rrumbullakosur sipas sistemit DC është 100 mw (DC) ose 90 mw (AC). Për sa argumentuar nga shoqëria dhe duke qenë se ERE jep licencë për kapacitetin e instaluar të shprehur në mw, licenca e shoqërisë do të jetë për kapacitetin total të instaluar 90 mw.

- Po ashtu, me shkresën e sipërcituar, shoqëria ka depozituar një pjesë të informacionit/ dokumentacionit plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është parë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore për arsye të sqarimit të mëtejshëm të dokumentacionit të munguar. Ndaj ERE, me shkresën nr. 2403/10 prot., datë 27.10.2025, i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e seancës dëgjimore.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancën e datës 3.11.2025, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë u mor angazhimi për të depozituar në ERE

informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2403/11 prot., datë 10.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE: “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltai me vendndodhje në Spitallë, Durrës, Shqipëri”, më datë 31.5.2021.

- Akt marrëveshjen “Marrëveshje përfundimtare në lidhje me marrëveshjen për zhvillimin e projektit për ndërtimin financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impianti fotovoltai me vendndodhje në zonën e Spitallës, Durrës, Shqipëri”, datë 20.12.2024.

- Me shkresat e “OST” sh.a., nr. 1512/4 prot., datë 17.6.2025 dhe nr. 1512/8 prot., datë 13.10.2025, ka marrë miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.

- Shoqëria është pajisur me deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 28.10.2025.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka deklaruar se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 30 vite, ashtu sikurse nga plani i biznesit rezulton se jetëgjatësia ekonomike është 30 vite, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit fotovoltai me rrjetin e transmetimit,



rezulton se shoqëria është brenda afatit të përcaktuar në miratimin në parim të dhënë nga “OST” sh.a. nëpërmjet shkresës së datës 17.6.2025, dhe ka dokumentuar që ka pranuar ofertën.

- Duke qenë se nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar apo nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse për pikën e lidhjes së centralit fotovoltai, duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltai, lidhja e tij me rrjetin elektrik është e garantuar, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me “OST” sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 28.10.2027, dhe duke marrë në konsideratë faktin se vetë shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda muajit dhjetor 2027, vlerësohet që t’i lihet asaj kusht që të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2027.

- Në referencë të sa parashikuar në pikën 6.8 të marrëveshjes së zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, por jo me vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 90 mw, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltai me rrjetin e transmetimit.

3. Shoqëria “Spitalla Solar” sh.p.k. duhet të fillojë operimin e centralit brenda datës 31.12.2027.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 303, datë 17.11.2025

#### MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “KLOS TORRENT WORKS” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “BANKA E PARË E INVESTIMEVE – ALBANIA” SHA.

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon





interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1828/8 prot., datë 13.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Klos Torrent Works’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Klos Torrent Works” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 1828/4 prot., datë 8.10.2025, ka paraqitur aplikimin dhe dokumentacion/informacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Klos Torrent Works” sh.p.k. (ish “MALIDO – ENERGJI” sh.p.k.), është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 23.10.2009, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Klos” me kapacitet prodhimi 1.519 kw, me vendndodhje në rrjedhën e lumit të Fanit, në rrethin e Mirditës.

- ERE, me shkresën nr. 1828/5 prot., datë 22.9.2025 dhe *email*-in e datës 4.11.2025, i ka bërë me dije dokumentacionin e pa plotësuar/plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria, me shkresat nr. 1828/6 prot., datë 10.11.2025 dhe nr. 1828/7 prot., datë 10.11.2025, ka përcjellë të plotë dokumentacionin e kërkuar.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Klos Torrent Works” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni,

në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

5. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores;

- Neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë që dokumentacioni të mos jetë i hapur për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

6. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Neni 8, pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës sigurorese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- Neni 8, pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë “Malido-Energji” sh.p.k., datë 22.5.2024 dhe vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë “Klos Torrent Works” sh.p.k., datë 11.7.2025, nëpërmjet të cilëve është miratuar vendosja e barrës sigurorese mbi 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a;

- germa “c” – marrëveshjen përkatëse:

- “Kontratën e kredisë bankare” nr. 2013 rep., nr. 635 kol., datë 22.5.2024, nënshkruar midis palëve;

- “Kontratën e kredisë bankare” me nr. 4954 rep., nr. 1586 kol., datë 7.11.2025, nënshkruar midis palëve;



- “Marrëveshjen siguruese” nr. 4957 rep., nr. 1589 kol., datë 7.11.2025, të nënshkruara midis palëve, ku është rënë dakord të barrësohen 100% të kuotave, me qëllim për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të garantuara të përcaktuara në kontratat e kredisë më sipër cituar.

- Neni 8, pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

7. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Klos Torrent Works” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Klos Torrent Works” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. (sipas kontratave të kredisë nr. 2013 rep., nr. 635 kol., datë 22.5.2024; nr.

4954 rep., nr. 1586 kol., datë 7.11.2025, si dhe marrëveshjen siguruese me nr. 4957 rep., nr. 1589 kol., datë 7.11.2025).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Klos Torrent Works” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Klos Torrent Works” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria lidhur me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar me MIE-n datë 3.12.2020 apo çdo akt tjetër i ndryshuar që i ka shërbyer kësaj vendimmarrjeje.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Klos Torrent Works” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 304, datë 17.11.2025

#### MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe 10, të “Rregullores



për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2769/1 prot., datë 13.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën nr. 2796 prot., datë 5.11.2025, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion, në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për miratim për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., rezulton se ajo plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e

përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe/ose përfaqësuesit ligjor të autorizuar me prokurë;

- Neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të tillë, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës, sipas nenit 7:

- Neni 7, pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë;

- Neni 7, pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- janë plotësuar të dhënat e kërkuara mbi identitetin e të licencuarit dhe adresën e tij, në përputhje me gërmat “a” dhe “b”, duke përfshirë emrin e plotë të të licencuarit dhe adresën e saktë të regjistruar;

- është dhënë informacion mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm të transferimit dhe ndikimin e tij në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, si dhe mbi kandidatën e propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë dhe kontributin financiar që ky kandidat do të japë në ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me gërmat: “c”, “d”, “e” dhe “f”;

- Pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë



autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së nga ku të reflektohet ndryshimi/transferimi i ortakut.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k.

2. Ortakët e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. ndryshojnë dhe bëhen z. A. G. dhe z. E. K., ku z. A. G. bëhet ortakë kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. (me 65% të kuotave të kapitalit).

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto palë.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 3.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**







Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 384 lekë

